


EPOKA

ERE

E përditshme e pavarur
Viti XXI, nr. 6272
E mërkurë, 24 mars 2021
çmimi 0.40 €

Prishtina me numrin më të madh të rasteve të infektimit me Covid

FAQE 3



Na ndiqni edhe në:

www.epokaere.com

facebook.com
Gazeta "Epoka e re"

AWR ABBRUCH GMBH
www.awr-abbruch.de

ALBIN KURTI PËR HERË TË DYTË KA MARRË DETYRËN E KRYEMINISTRIT | FAQE 4-5

KURTI KËRKON NGA MINISTRAT T'I PËRVJELIN MËNGËT



Një ditë pasi ka marrë besimin e Kuvendit, Albin Kurti ka pranuar zyrtarisht detyrën e kryeministrit nga kryeministri i deritashëm Avdullah Hoti. Pas ceremonisë shtetërore të dorëzimit pranimit,

Kurti ka thirrur mbledhjen e kabinetit të tij, në të cilën ka folur për sfidat që e presin qeverinë e re. Ai ka pranuar se pritjet e qytetarëve janë të mëdha, derisa ka kërkuar nga vartësit e tij që t'i përvjelin mëngët e

të fillojnë punët e mëdha që i presin. Kurti ka kërkuar plan urgjent për menaxhimin e pandemisë, i cili, sipas tij, do t'i ulte rastet e infektimit dhe t'i eliminonte vdekjet e reja nga Covid-19

QUINTI KËRKON NGA POZITA DHE OPOZITA TË BASHKËPUNOJNË PËR ZGJEDHJEN E PRESIDENTIT

FAQE 5



RRETH 250 MIJË ARMË ILEGALE JANË NË POSEDIM TË QYTETARËVE TË KOSOVËS

FAQE 7

RENOVA
PUTZ
Maqedoni
Xhepçisht - Tetovë
Gurëz-Ferizaj
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009
+389 44 487 755
Fax: +389 44 487 200
Mob: +377 44 501 289
E-mail: renova@mt.net.mk

PRINCESHA
GROUP SH.P.K.
NDËRTIM
PROJEKTIM
SHITJE
INFO: 049-111-101,
044-511-177
www.princesha-ks.com

Bunjamini
FABRIKA E LLAQEVE
MITROVICË
044/256-051
044/367-061
028/532-617
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË

Kolegji BIZNESI
www.kolegji.biznesi.com
info@kolegji.biznesi.com
030 500 878 | 045 500 878
044 500 878 | 049 500 878

SIGMA
VIENNA INSURANCE GROUP
SIGMA INTERALBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A
DEGA KOSOVË
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë,
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302,
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

INFINITY
Digital Agency
Endrit Shaqiri
+38344685122
Internet Website,
Marketing...

OPINION

HISTORIA ËSHTË RROTULLUAR NË TË MBARË TË SHQIPTARËVE F. 10

Shkruan:
Bedri ISLAMI



COVID-19, LUFTA E PADUKSHME F. 8

Shkruan: Lul RAKA



AKTUALE

SHBA-JA ZOTOHET PËR ANGAZHIMIN E PALËKUNDUR NDAJ NATO-S F. 7

SOT MBAHET SEANCA E RADHËS NDAJ THAÇIT, VESELIT, KRASNIOQIT DHE SELIMIT F. 7



EKONOMI

OAK-u PRET BASHKËPUNIM NGA QEVERIA E RE ME SEKTORIN PRIVAT F. 9

GORDANI: PROJEKTI TAP NUK ËSHTË THJESHT NJË TUBACION QË SJELL GAZ F. 9

KULTURË

NË BIBLIOTEKËN E QYTETIT TË PODUJEVËS HAPET KËNDI I ARKIVAVE TË SHQIPËRISË F. 6

ShBA-ja paralajmëron Gjermaninë për sanksione të mundshme

WASHINGTON, 23 MARS - Sekretari amerikan i Shtetit, Antony Blinken, e ka paralajmëruar Gjermaninë për sanksione të mundshme për shkak se ka lejuar ndërtimin e tubacionit të gazit rus "Rrjedha Veriore 2". Blinken ka pohuar se ky projekt është kundër interesave të vetë Bashkimit Evropian. "Presidenti (Joe) Biden ka qenë shumë i qartë. Ai beson se tubacioni është një ide e keqe për Evropën, për Shtetet e Bashkuara. Ky projekt, në fund të fundit, është në kundërshtim edhe me qëllimet e sigurisë së BE-së", ka theksuar Blinken, pas takimit me sekretarin e përgjithshëm të NATO-s, Jens Stoltenberg, në Bruksel.

Gjermania po e shtyn përpara përfundimin e ndërtimit të tubacionit pavarësisht prej kundërshtimit të gjatë të Shteteve të Bashkuara. Zyrtarët amerikanë kanë thënë se gazsjellësi do ta bëjë Evropën shumë të varur nga furnizimet e energjisë ruse. Ky tubacion parashihet se do të transportojë 55 miliardë metra kub gaz natyror çdo vit drejtpërdrejt nga Rusia në Gjermani. Ai, gjithashtu, do ta anashkalojë Ukrainën, një vend aleat i Perëndimit. Në deklaratën e tij, Blinken përmendi një ligj, sipas të cilit, ShBA-ja është e detyruar të vendosë sanksione ndaj kompanive pjesëmarrëse në projektin "Rrjedha Veriore 2".

ShBA-ja vlerëson se ky projekt do t'i minojë "interesat e Ukrainës, Polonisë dhe një numri vendesh aleatë". Blinken ka thënë se për mundësinë e vendosjes së sanksioneve ndaj Gjermanisë ai do ta paralajmërojë edhe homologun e tij gjerman, Heiko Maas, në takimin e tyre më 23 mars. Deri më tani Uashingtoni ka vendosur vetëm sanksione ndaj ndërmarrjes ruse KVT-RUS, e cila operon me anije për vendosjen e tubave. Sanksionet u shpallën nga administrata e presidentit amerikan Donald Trump pak para përfundimit të mandatit të saj në janar. Rreth 95 për qind e punës për



ndërtimin e gazsjellësit tashmë është përfunduar. Sipas ekspertëve, projekti mund të përfundojë deri në shtator. Mbeshtetësit e ndërtimit të

këtij gazsjellësi kanë akuzuar prej kohësh Shtetet e Bashkuara për pengimin e projektit, duke thënë se Uashingtoni po synon shitjen e gazit të lëngshëm në Evropë.

Gjermania vendos për zgjatjen e masave të izolimit

BERLIN, 23 MARS - Gjermania do ta zgjasë masën e izolimit të pjesëshëm në të gjithë vendin deri më 18 prill. Pas bisedimeve disaorëshe, kancelarja Angela Merkel dhe udhëheqësit e landeve ranë dakord për një bllokim pesëditor gjatë festës së Pashkëve. Pothuajse të gjitha dyqanet do të mbyllën nga data 1 deri më 5 prill. Vetëm supermarketet do të lejohen të hapen më 3 prill.



"Tani jemi në një situatë shumë serioze", ka deklaruar Merkel në një konferencë për media, duke e përshkruar variantin më vdekjeprurës dhe infektiv të koronavirusit të identifikuar për herë të parë në Britani të Madhe si një "pandemi e re". Kryeministri i Bavarisë, Markus Soeder, ka qenë një mbrojtës i vendosjes së masave të izolimit. Soeder ka thënë se Gjermania mbase po kalonte

periudhën më të rrezikshme të pandemisë. Sipas tij, varianti i ri nuk ishte vetëm më infektues dhe vdekjeprurës, por ndikon më shumë sesa vetëm të moshuarit. Vendimi për t'i zgjatuar kufizimet erdhi pasi numri i të infektuarve për 100 000 banorë u rrit në mbi 100 gjatë javës së kaluar. Zakonisht një rritje e tillë detyron qeveritë të ndërmarrin masa më të ashpra të izolimit.

ShBA-ja zotohet për angazhimin e palëkundur ndaj NATO-s

BRUKSEL, 23 MARS - Sekretari amerikan i Shtetit, Antony Blinken, në udhëtimin e tij të parë në Bruksel, është zotuar ta rindërtojë dhe forcojë NATO-n dhe të konsultohet me aleatët për veprimet e ardhshme në Afganistan. Blinken po merr pjesë në një takim të ministrave të jashtëm të NATO-s më 23-24 mars. Ai

do të zhvillojë bisedime me udhëheqësit e Bashkimit Evropian si pjesë e përpjekjeve të presidentit të ShBA-së, Joe Biden, për t'i riparuar raportet transatlantike. "Unë kam ardhur këtu për ta shprehur angazhimin e palëkundur të Shteteve të Bashkuara (ndaj NATO-s)", u tha Blinken

gazetarëve pas takimit me sekretarin e përgjithshëm të NATO-s, Jens Stoltenberg. Temat e diskutimit në samitin e ministrave të Jashtëm të NATO-s janë shqetësimet mbi Kinën dhe Rusinë, si dhe e ardhmja e misionit të aleancës perëndimore në Afganistan, ku gjenden 9 600 ushtarë të saj.



Sulm me armë zjarri në një supermarket në Kolorado, dhjetë të vrarë



BOULDER, 23 MARS - Policia në qytetin Boulder të shtetit Kolorado ka njoftuar se dhjetë persona u vranë me armë zjarri në një dyqan ushqimesh. Shefja e policisë e qytetit Boulder, Maris Herold, ka theksuar se mes të

vrarëve ishte oficeri Eric Talley, i pari që mbërriti në vendngjarje pas njoftimeve për të shtëna armësh. Ajo i quajti veprimet e oficerit Talley "heroike". Herold u ka thënë gazetarëve në një konferencë për media

se një i dyshuar ishte ndaluar dhe se hetimi pritej të zgjaste të paktën pesë ditë. Policia ka njoftuar se incidenti ndodhi në supermarketin "King Soopers" në Boulder, një qytet rreth 45 kilometra në veriperëndim të Denverit.

Prishtina me numrin më të madh të rasteve të të infektuarve me Covid

Gjatë 24 orëve të fundit në Komunën e Prishtinës janë konfirmuar 320 raste të reja me Covid. Instituti Kombëtar i Shëndetësisë Publike i Kosovës (IKShPK) ka njoftuar për vdekjen edhe të dhjetë pacientëve nga ky virus. Brenda 24 orëve janë konfirmuar edhe 705 raste të reja me Covid në Kosovë

EPOKA
ERE

Faton DËRMAKU

PRISHTINË, 23 MARS - Gjatë 24 orëve të fundit në Laboratorin e Mikrobiologjisë Molekulare në Institutin Kombëtar të Shëndetësisë Publike të Kosovës (IKShPK) dhe në laboratorët privatë me metodën RT-PCR si dhe në laboratorët publikë dhe privatë me metodën RAT janë testuar gjithsej 3 922 mostra të marra nga Shërbimi Spitalor dhe Klinik Universitar i Kosovës (ShSKUK) dhe gjurmimi i kontakteve të rasteve në terren, prej të cilave kanë rezultuar 705 raste pozitive me Covid-19. Brenda 24 orëve janë raportuar

dhjetë raste të vdekjes si pasojë e këtij virusi.

Rastet e të vdekurve janë nga komunat: Kamenicë tri raste (71, 68, 62 vjeç), Rahovec dy raste (85, 50 vjeç), Ferizaj një rast (81 vjeç), Fushë-Kosovë një rast (78 vjeç), Pejë një rast (79 vjeç), Viti një rast (51 vjeç) dhe Vushtrri një rast (87 vjeç).

Numri total i rasteve pozitive është 83 717 raste nga 393 713 persona të dyshimtë me këtë virus dhe 1 786 raste të të vdekurve që prej paraqitjes të këtij virusi në Kosovë.

Gjatë 24 orëve të fundit janë shëruar 522 pacientë, kurse numri i përgjithshëm i të shëruarve deri më sot është

gjithsej 69 123 raste, ndërsa numri i rasteve aktive është 12 808.

Rastet pozitive janë nga komunat: Prishtinë 320 raste, Lipjan 50 raste, Fushë-Kosovë 41 raste, Prizren 37 raste, Gjakovë 30 raste, Kamenicë 27 raste, Obiliq 27 raste, Gjilan 25 raste, Pejë 20 raste, Deçan 19 raste, Podujevë 17 raste, Drenas 15

raste, Vushtrri 15 raste, Malishevë 13 raste, Klinë 9 raste, Shtime 7 raste, Mitrovicë 5 raste, Rahovec 5 raste, Kaçanik 4 raste, Novobërdë 4 raste, Dragash 3 raste, Istog 3 raste, Graçanicë 2 raste, Skenderaj 2 raste, Suharekë 2 raste, Viti 2 raste dhe Ferizaj 1 rast.

Instituti Kombëtar i Shëndetësisë Publike i Kosovës

ka theksuar se numri i rasteve pozitive dhe i të vdekurve nga Covid-19 vazhdon të jetë i lartë dhe brengosës si pasojë e drejtpërdrejtë e neglizhimit të masave.

IKShPK-ja përsërit thirrjen për zbatimin e të gjitha masave të përgjithshme dhe specifike për mbrojtjen nga pandemia Covid-19.

Avokati gjen gabime të dukshme në aktakuzë, i kërkon gjykatësit ta rishikojë vendimin për mbajtjen e Veselit në paraburgim

PRISHTINË, 23 MARS - Mbrojtja e ish-kryeparlamentarit të Kosovës, Kadri Veseli, para pak ditësh e ka çuar në Gjykatën Speciale një mocion, përmes të cilit kundërshton aktakuzën kundër tij dhe ish-udhëheqësve të tjerë politikë e ushtarakë të UÇK-së. Në këtë mocion avokati Ben Emmerson përmend rastin e gjykimin të Ramush Haradinajt për të argumentuar se, sipas tij, Zyra e Prokurorit të Specializuar ka bërë gabime në përshkrimin e ngjarjeve gjatë kohës për të cilën akuzohet Veseli, ndërsa i ka kërkuar gjykatësit ta urdhërojnë prokurorinë që t'i heqë nga aktakuza krimet e pretenduara para mesit të vitit 1998 dhe pas qershorit 1999.

Sipas avokatit, një dhomë e Gjykatës Penale Ndërkombëtare e Hagës për krimet në ish-Jugosllavi kishte pranuar se kishte pak prova specifike për përplasjet midis UÇK-së dhe forcave serbe midis 25 marsit dhe 21 prillit 1998. Por në mocion, avokati thekson se "UÇK-ja s'ishte organizuar brenda natës". "Sidoqoftë, ndryshe nga rasti i mëparshëm Limaj, Dhoma vendosi që rifillimi i përplasjeve më 22 prill 1998 përfundimisht shkaktoi zbatimin e ligjit të konfliktit të



armatosur në të gjithë territorin e Kosovës. Gjetja e Dhomës Gjyqësore në procedurat e para në rastin Haradinaj nuk pasqyron një interpretim të saktë të rastit Tadiq sepse dhuna e armatosur sporadike nuk zgjati nga një ditë në tjetrën (nga 21 deri më 22 prill 1999) thjesht sepse rifilluan përplasjet midis UÇK-së dhe forcave serbe atë ditë dhe as UÇK-ja papritmas s'u bë e organizuar brenda natës", thuhet në mocion.

Aty përmendet se një dhomë tjetër e kësaj gjykate, në rigjykimin e Haradinajt,

hezitonte ta pranonte 22 prillin 1998 si fillimin e luftimeve midis UÇK-së dhe forcave serbe. "Në procedurën e rigjykimin, Haradinaj, një dhomë tjetër e ICTY, ishte shumë hezituese për pranimin e 22 prillit 1998 si fillim i konfliktit të armatosur midis UÇK-së dhe forcave serbe, posaçërisht refuzuan propozimin e prokurorisë që një konflikt i armatosur ekzistonte midis 1 marsit 1998 dhe 21 prillit 1998. Ndërsa dhoma nuk ishte dukshëm e bindur që një konflikt i tillë ekzistonte deri më 22 prill 1998, megjithatë e pranoi një

konstatim të tillë vetëm sepse palët e kishin bërë tashmë me marrëveshje 22 prillin 1998 si datë prove", thuhet në mocionin e mbrojtjes.

Si përfundim, mbrojtja thotë se "çdo referencë në marsin 1998 si datë e fillimit të konfliktit nuk ka asnjë bazë në provat e paraqitura nga ZPS", duke konstatuar një gabim faktik nga Prokuroria në përcaktimin e përfundimit të konfliktit të armatosur. "Gjykatësi përmend dy shembuj për ta mbështetur pohimin e tij se luftimet nuk mbaruan deri më 16 shtator 1999: (i) një incident më 10 gusht 1999 (10 raunde mortaje që qëlluan një fshat serb) dhe (ii) raporte të sulmeve me mortaja dhe eksplozivë kundër vendeve fetare serbe në fund të gushtit 1999", theksohet në mocion. Mbrojtja thotë se, sipas fakteve, "të gjitha luftimet përfunduan deri më 10 qershor 1999". "Fundi i luftimeve midis UÇK-së dhe forcave serbe është i lidhur pazgjidhshmërisht deri në fund të luftimeve të forcave të NATO-s ndaj Serbisë. [...] Përkundër konstatimit të gjykatësit, forcat serbe nuk 'filluan t'i rishpërndanin disa nga njësitë e tyre jashtë Kosovës në qershor 1999, por në vend të kësaj forcat serbe tërhoqën të gjitha njësitë e

tyre nga territori i Kosovës deri më 20 qershor 1999", thuhet në këtë mocion.

Sipas mbrojtjes, ZPS s'e thotë të vërtetën kur pretendon se ekzistonte rreziku i rifillimit të armiqësisë, sepse UÇK-ja ka mbajtur depo të paautorizuara të armëve. "ZPS pretendon se UÇK-ja ka mbajtur depo të paautorizuara të armëve në stacionet e policisë dhe mjediset e paraburgimit; dhe UÇK-ja dhe forcat ish-jugosllave vazhduan armiqësinë dhe veprimet provokuese të paktën deri në shtator 1999. Këto 'shkelje' ose 'akte provokuese' ishin të rregullta dhe, në fakt, pritshin në një zonë pas konfliktit, por qartazi nuk arrijnë të vlerësojnë ose paraqesin një rrezik real të rifillimit të armiqësisë", thuhet në mocion.

Si përfundim, mbrojtja i kërkon gjykatësit që ta rishikojë vendimin për konfirmimin e aktakuzës në përputhje me rrethanat, ta urdhërojë ZPS-në që ta ndryshojë aktakuzën për t'i përjashtuar pretendimet në lidhje me incidentet e krimeve të luftës, mbajtjes së paligjshme, trajtimin mizor, torturat dhe vrasjet që pretendohet të kenë ndodhur para mesit të vitit 1998 dhe pas qershorit 1999.



ALBIN KURTI PËR HERË TË DYTË KA MARRË DETYRËN E KRYEMINISTRIT

Kurti kërkon nga ministrat t'i përvjelin mëngët dhe të punojnë

Një ditë pasi ka marrë besimin e Kuvendit, Albin Kurti ka pranuar zyrtarisht detyrën e kryeministrit nga kryeministri i deritashëm Avdullah Hoti. Pas ceremonisë shtetërore të dorëzimit pranimit, Kurti ka thirrur mbledhjen e kabinetit të tij, në të cilën ka folur për sfidat që e presin qeverinë e re. Ai ka pranuar se pritjet e qytetarëve janë të mëdha, derisa ka kërkuar nga vartësit e tij që t'i përvjelin mëngët e të fillojnë punët e mëdha që i presin. Kurti ka kërkuar plan urgjent për menaxhimin e pandemisë, i cili, sipas tij, do t'i ulte rastet e infektimit dhe t'i eliminonte vdekjet e reja nga Covid-19

ministrat. “Qytetarët presin punë dhe angazhim, përfaqësim të dinjitetshëm dhe udhëheqje përmes shembullit. Në ditët në vazhdim pres që secili nga ju të vini me propozime për vendime konkrete të cilat i kemi identifikuar me vite e të cilat kërkojnë zgjidhje. Unë besoj në dijen dhe kapacitetet tuaja, por tash është koha që ju ta dëshmoni para qytetarëve se në pozitë që jeni vendosur, që jemi vendosur, jemi meritorë. Sfidat janë të mëdha”, është shprehur ai.

Përtej veprimeve urgjente për menaxhimin e pandemisë, ka thënë Kurti, duhet të veprohet

shpejt për ndalimin e humbjeve financiare nga kompanitë publike, por edhe të ndalet recesioni ekonomik duke ndihmuar sektorin privat që t'i shpëtojë vendet e punës dhe prodhimin. “Në ndërmarrjet publike duhet të ketë auditime dhe vlerësim të performancës. Aty ku gjejmë shkelje të ligjit dhe performancë të dobët duhet të veprojmë shpejt për kthimin e ligjshmërisë, por edhe për vendosjen e një menaxhmenti i

EPOKA E RE **Muhamet KOCI**

PRISHTINË, 23 MARS - Me ceremoni shtetërore, kryeministri i ri i Kosovës, Albin Kurti, të martën ka marrë detyrën e cila i është dorëzuar nga kryeministri i deritanishëm, Avdullah Hoti. Pas marrjes së detyrës, Kurti ka mbledhur kabinetin qeveritar, në të cilën ka përmendur sfidat kryesore me të cilat do të përballen.

Në mbledhjen ceremoniale ai ka thënë se pritjet e qytetarëve për këtë qeveri janë të mëdha.

Në fillim të adresimit të tij, shefi i ekzekutivit ka paralajmëruar plan për menaxhimin e pandemisë. “Jemi ende në një krizë shëndetësore dhe ekonomike. Deri sot kemi mbi 83 mijë persona të infektuar dhe 1 776 të vdekur deri dje

zyrtarisht. Vetëm në 24 orët e fundit kishim 827 raste të reja dhe 16 të vdekur. Këta nuk janë thjesht numra dhe statistika, por janë jetë njerëzish, janë familjarë, vëllezër e motra, prindër e gjyshër të cilët do të mungojnë në tavolinat e ushqimit në secilën shtëpi”, ka thënë Kurti, duke shtuar se duhet të veprojmë me urgjencë për parandalimin e përhapjes së Covid-19. “Andaj duhet të veprojmë me urgjencë që t'i ulim rastet dhe t'i eliminojmë vdekjet e reja si rezultat i virusit Covid-19, por duhet të ketë plane të zbatueshme të cilat marrin parasysh shëndetin fizik dhe shëndetin e ekonomisë të vendit tonë. Balancimi i këtyre duhet të bëhet përmes një plani që duhet të hartohet me urgjencë nga Ministria e Shëndetësisë, e

Ekonomisë dhe ministrave të tjera”, është shprehur kryeministri Kurti.

Ai ka thënë se kërkohen punë konkrete dhe rezultate sa më të shpejta. Sipas Kurtit, rezultati i këtij kabineti varet nga puna e secilit dhe ekipet që ndërtojnë



Në secilën ministri është bërë dorëzimi pranimit i detyrës

Pas marrjes së detyrës së kryeministrit të ri, edhe ministrat kanë mbajtur ceremonitë e dorëzimit pranimit të detyrës. Në këto ceremoni ministrat e rinj janë njoftuar me punën dhe sfidat në fushat që mbrojnë. Ata janë zotuar se do të punojnë ngushtë me të gjithë në shërbim të qytetarëve, ndërsa ish-ministrat u kanë uruar suksese atyre.

cili ka aftësinë dhe vullnetin dhe vizionin që t'i kthejë ndërmarrjet publike në mbështetës të ekonomisë. Pres që në tavolinën time të vij urgjent si plani për menaxhimin të pandemisë, po ashtu edhe plani për ringjalljen ekonomike", ka thënë Kurti.

Në fjalën e tij, ai ka kërkuar nga vartësit e tij që të punojnë me nder dhe përgjegjësi. "Të udhëhiqemi nga parimet më të mira, nga zotimet tona dhe nga interesat e qytetarëve. Të kërkojmë ndihmë dhe bashkëpunim nga të gjithë dhe le t'i përvjelim mëngët e t'i fillojmë punët e mëdha që na presin neve dhe angazhimin e përditshëm që pritët prej nesh", ka thënë Kurti.

Kurti dhe Konjufca vizitojnë Prekazin

Kryeministri i Kosovës, Albin Kurti, në ditën e parë të punës në krye të qeverisë, ka bërë homazhe te Kompleksi Memorial "Adem Jashari" në

Prekaz. Para mediave, Kurti ka deklaruar se falë sakrificës së familjes Jashari Kosova gëzon lirinë. "Çdoherë kur marrim detyra të rëndësishme shtetërore, çdo pozitë e lartë institucionale duhet të themelohet mbi kthimin dhe rikthimin tek Jasharët dhe te Prekazi, te ky kryeqytet i kryengritjes sonë kombëtare. Lavdi gjithë heronjve, dëshmorëve e martirëve të kombit, falë të cilëve ne jemi sot edhe të gjallë dhe gëzojmë lirinë që kemi!", ka deklaruar Kurti.

Kurse u. d. i presidentit, Glauk Konjufca, ka thënë se kujtimi ndaj familjes Jashari do të jetë i përhershëm. "Ne jemi në Prekaz që të marrim forcë se si të vazhdojmë dhe ecim përpara, meqë ky është vendi ku në vitin 1998 kombi shqiptar u ringjall dhe sakrificat e madhe e familjes Jashari e lëvizti krejt botën dhe e bëri botën që të rreshtohet në anën e interesit të kombit shqiptar. Pikërisht për këtë arsye do të jetë i përhershëm dhe i përvetshëm kujtimi i të gjithë



kombit shqiptar për këtë sakrificë të madhe të familjes Jashari", ka deklaruar Konjufca. Një ditë më parë qeveria Kurti ka marrë besimin e 67 deputetëve të Kuvendit të Kosovës. Kurti ekzekutivin e ri e ka formuar me partitë e komuniteteve joserbe. Qeveria e tij ka tre zëvendëskryeministra dhe 15 ministri, pesë prej të cilave do të udhëhiqen nga gra. Kurti për herë të dytë ka marrë postin e kryeministrit, pasi në shkurtin e vitit të kaluar ai u zgjodh për herë të parë në këtë post. Por, partnerja e atëhershme e koalicionit, Lidhja Demokratike e Kosovës, e rrëzoi Qeverinë Kurti dhe udhëheqjen e qeverisë e mori Avdullah Hoti. Në fund të vitit të kaluar, Gjykata Kushtetuese konstatoi se Qeveria Hoti ishte jolegjitime pasi për të kishte votuar një deputet që kishte qenë i dënuar me vendim të formës së prerë në tre vjetët e fundit.

Kurti merr urime nga ambasadorë dhe zyrtarë të lartë të BE-së

Kryeministri Albin Kurti ka marrë shumë urime për marrjen e detyrës nga ambasadorë të akredituar në Prishtinë dhe zyrtarë të lartë të BE-së. Ambasadori amerikan Philip Kosnett, me anë të një postimi në "Twitter", ka thënë se shpreson në një bashkëpunim të thellë me qeverinë e re në të mirë të ndërtimit të paqes, drejtësisë dhe prosperitetit për të gjithë qytetarët e vendit. "Urime kryeministrit Albin Kurti dhe qeverisë së re. Shpresojmë të punojmë së bashku për të ndërtuar një të ardhme të paqes, drejtësisë dhe prosperitetit për të gjithë qytetarët e Kosovës dhe, më urgjentisht, për të mposhtur Covid-19. Mbani maskën", ka shkruar Kosnett. Kurti është uruar nga

ambasadorët e vendeve të Quintit dhe zyrtarë të lartë të BE-së. Shefi i politikës së jashtme i Bashkimit Evropian (BE), Joseph Borrell, në urimin e tij ka treguar edhe për pritjen që ka nga qeveria e re. "Urime kryeministrit të ri të Kosovës, Albin Kurti! Presim të punojmë së bashku për ta sjellë dialogun Beograd - Prishtinë në një mbyllje të suksesshme. Kjo është thelbësore për rrugën evropiane. BE-ja mbështet plotësisht agjendën e reformave dhe trajtimin e Covid-19", ka shkruar Borrelli në llogarinë e vet në "Twitter". Në ditën e parë të punës si kryeministër, Kurti ka pritur edhe mysafirë. Takimin e parë e ka zhvilluar me Zyrën e Bashkimit Evropian në Kosovë, Tomas Szunyog.



Quint-i kërkon nga pozita dhe opozita të bashkëpunojnë për zgjedhjen e presidentit

PRISHTINË, 23 MARS - Shtetet e Quint-it thonë se detyra e parë e institucioneve të reja të Kosovës është zgjedhja e presidentit të ri të vendit. Përmes një deklarate, përfaqësuesit e Shteteve të Bashkuara, Gjermanisë, Mbretërisë së Bashkuar dhe Francës, kanë uruar Kosovën për zgjedhjen e kuvendit dhe qeverisë së re. "Në këtë kohë të pandemisë dhe sfidave ekonomike, Kosova ka nevojë për udhëheqësi të vendosur dhe institucione qeverisëse funksionale që sigurojnë stabilitet, përfshirë edhe presidencën. Adresimi i këtyre sfidave do të kërkojë që prijësit e partive politike dhe deputetët e zgjedhur tani t'i vënë nevojat e qytetarëve të Kosovës mbi çështjet partiake politike dhe që opozita dhe qeveria të punojnë për prioritetet e përbashkëta, e detyra e parë është zgjedhja e presidentit të ri", thuhet në deklaratën për media.

Më 22 mars u konstituua Kuvendi i ri dhe po të njëjtën ditë u zgjodh edhe Qeveria e re e Kosovës e udhëhequr nga Albin Kurti i Lëvizjes Vetëvendosje. Sfidat e radhës për partinë e Kurtit është që ta zgjedhë edhe presidentin e ri të vendit. Për këtë post, kjo parti ka nominuar Vjosa Osmanin. Por, Osmani nuk po përkraket nga partitë opozitare - Partia Demokratike e Kosovës dhe Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës. Ndërkaq, ish-partia e saj, Lidhja Demokratike e Kosovës, ende nuk e ka bërë të qartë nëse do ta votojë ose jo Osmanin për një mandat pesëvjeçar në krye të shtetit. Ndërkaq, partitë e komuniteteve joserbe kanë shprehur përkrakjen e tyre për Osmanin.

Që prej 5 nëntorit 2020 Kosova është me ushtrues detyre të presidentit, pasi Hashim Thaçi dha dorëheqje nga kjo pozitë



pas konfirmimit të aktakuzës për krime lufte dhe krime kundër njerëzimit nga Dhoma e Specializuar në Hagë. Që nga 5 nëntori deri më 22 mars këtë post e ushtroi Osmani dhe, pas zgjedhjes në krye të kuvendit, Glauk Konjufca mori edhe detyrën e

ushtrimit të postit të presidentit. Që një person të zgjidhet president i Kosovës, sipas Kushtetutës, në dy raundet e para të votimit duhet të sigurojë dy të tretat e votave të Kuvendit të Kosovës prej 120 ulësesh. Ndërkaq, në raundin e tretë

president zgjidhet ai që merr shumicën e thjeshtë prej 61 deputetësh, por në votim duhet të marrin pjesë të paktën 80 deputetë. Nëse edhe raundi i tretë dështon, vendi shkon në zgjedhje të jashtëzakonshme të cilat duhet të mbahen brenda 45 ditësh.

Nënshkruhet marrëveshja për investime në Kaçanik në vlerë afër 1 milion euro

Kaçanik, 23 mars (ER) - Investimi në vlerë 700 mijë euro si dhe 20 të punësuar fillimisht është marrëveshja e nënshkruar në mes të kryetarit të Komunës së Kaçanikut, Besim Ilazi, si dhe mes kompanisë "Kaçinka" përfaqësuar nga Jetmir Shehu.

Kryetari Ilazi ka thënë se me

vendim të Kuvendit Komunal është dhënë në shfrytëzim prona komunale në afat për 40 vjet, ndërsa kompania në fjalë është e obliguar që sipas projektpropozimit të paraqitur edhe në kuvend, ta vazhdojë punën dhe dinamikën e përmbushjes së projektit të planifikuar.

Ilazi ka pohuar se përmes

kësaj marrëveshje synohet të arrihet zhvillimi ekonomik si dhe të rritet numri i të punësuarve në këtë komunë. Ai ka bërë me dije se pas investimeve në infrastrukturën rrugore, tashmë çdo investues në Kaçanik do të ketë kushte të përshtatshme për zhvillim të veprimtarive të ndryshme.



Në bibliotekën e qytetit të Podujevës hapet këndi i arkivave të Shqipërisë

PODUJEVË, 23 MARS (ER) - Kryetari i Komunës së Podujevës, Shpejtim Bulliqi, ka pritur në takim drejtorin e përgjithshëm të Arkivave të Shqipërisë, Ardit Bido dhe kryeshefin ekzekutiv të Agjencisë së Arkivave të Kosovës, Bedri Zyberaj, me ç'rast është nënshkruar marrëveshje bashkëpunimi.

Gjatë takimit Bulliqi me drejtorin e përgjithshëm të Arkivave të Shqipërisë është biseduar për format e bashkëpunimit në mes të dy institucioneve. Me këtë rast, kryetari Bulliqi dhe drejtori i përgjithshëm i Arkivave të Shqipërisë, Ardit Bido, nënshkruan marrëveshje për bashkëpunim për ofrimin e shërbimit të sallës së studimit të



Arkivave të Republikës së Shqipërisë në qytetin e Podujevës. Në bazë të kësaj marrëveshjeje Komuna e Podujevës do ta ketë këndin arkivor të Tiranës në bibliotekën e qytetit në Podujevë, ku do të jenë të vendosur dy

kompjuterë të cilët do të jenë në shërbim të studiuesve për konsultim arkivor. Kjo marrëveshje ka për qëllim edhe bashkëpunimin dhe bashkimin institucional në mes të Kosovës dhe Shqipërisë.

QKMF-ja në Rahovec fillon të bëjë teste rapide për Covid-19

Rahovec, 23 mars (ER) - Kryetari i Komunës së Rahovecit, Smajl Latifi, ka bërë me dije se Qendrat Kryesore të Mjekësisë Familjare (QKMF) në këtë komunë kanë filluar bërjen e testeve rapide për Covid-19. "Me qëllim që të kemi një vlerësim më objektiv dhe më të qartë për gjendjen epidemiologjike me Covid-19,

ekipi ynë i QKMF-së në Rahovec ka filluar me teste rapide, ku rezultatet janë të shpejta dhe të sakta. U bëj thirrje qytetarëve të Komunës së Rahovecit ta shfrytëzojnë mundësinë e krijuar dhe ta marrin shërbimin për të mirën e tyre, çdo ditë pune, prej orës 10:00 deri në orën 13:00", ka njoftuar Latifi.



Pronarët e tokave në fshatin Uglar i japin mbështetje impiantit të ujërave të zeza

Gjilan, 23 mars (ER) - Në Komunën e Gjilanit është mbajtur dëgjim publik me pronarët e tokave nga fshati Uglar, ku është prezantuar projekti për impiantin e ujërave të zeza dhe veprimet që do të marrë komuna lidhur me shpronësimin e pronave private për interes të përgjithshëm, bazuar në vendimin e Kuvendit të Komunës.

Drejtori i Drejtorisë Komunale



për Kadastër, Gjeodezi dhe Pronë, Sali Fazliu, ka potencuar hapat që ka marrë Komuna e Gjilanit dhe ecurinë e planifikimit të deritashëm për implementimin e projektit të impiantit që nga ekspertët të cilët kanë bërë studimin e fizibilitetit është vlerësuar se duhet të vendoset në bashkimin e lumenjve Morava, Mirusha dhe Stanishorka. Fazliu, gjithashtu, ka theksuar

se rëndësia e këtij projekti është e jashtëzakonshme dhe në kuadër të këtij projekti është planifikuar edhe ndërtimi i kolektorëve të cilët trajtojnë edhe lumenjtë e tjerë. Ai ka njoftuar se ky projekt është meritë e kryetarit Lutfi Haziri i cili ka siguruar edhe mjetet buxhetore përmes Qeverisë së Republikës së Kosovës dhe Bankës Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim që është financuese e projektit.

Fillon shpërndarja e shujtave ushqimore për nxënësit në Prizren

Prizren, 23 mars (ER) - Kryetari i Komunës së Prizrenit, Mytaher Haskuka, të martën, së bashku me drejtoreshën e Drejtorisë Komunale të Arsimit, Xhemile Thaçi-Vezgishi, ka bërë shpërndarjen e shujtave të para për nxënësit e klasave parafillore dhe të klasave 1-5 në Shkollat

Filllore "Haziz Tola" në Prizren, "Dëshmorët e Zhurit" në Zhur dhe "Meto Bajraktari" në Reçanë. Duke e cilësuar këtë projekt tejet të rëndësishëm, Haskuka ka thënë se brenda këtyre shujtave ushqimore përfshihen kifle të llojeve të ndryshme, me paketime higjienike për pesë ditë të

javës, si dhe nga një qumësht një herë në javë. Duke theksuar se ky projekt ka qenë një prej premtimeve të tij, Haskuka ka njoftuar se do të vazhdojë të punojnë për të mirën e qytetarëve, në veçanti të fëmijëve, të cilët janë bazamenti i një të ardhmeje të ndritur për shtetin.



Rreth 250 mijë armë ilegale janë në posedim të qytetarëve të Kosovë

PRISHTINË, 23 MARS - Rreth 250 mijë armë ilegale janë në posedim të qytetarëve të Kosovë, sipas të dhënave të Ministrisë së Punëve të Brendshme. Dhe ky numër po paraqet kërcënim serioz të sigurisë publike. Në Kosovë, vetëm në vitin e kaluar nga armët pa leje, sipas Policisë së Kosovës, janë kryer 29 vrasje. Ndërkaq, po në të njëjtin vit Policia e Kosovës ka konfiskuar 1 135 armë zjarri dhe mbi 32 700 municione të kalibrave të ndryshëm. Policia e Kosovës ka treguar se konfiskimi i armëve është bërë në nivel vendi, duke mos u përgjigjur në pyetjen nëse ata kanë hasur në shitjen e këtyre armëve në treg të zi. "Veprime ligjore janë ndërmarrë nga organet e drejtësisë ndaj personave të dyshuar të përfshirë në veprime të kundërligjshme, përfshirë edhe posedim ilegal të armëve dhe municionit", thuhet në përgjigjen e Policisë së Kosovës për "Radion Evropa e Lirë".

Dënimi për armëmbajtje pa leje përcaktohet sipas Kodit Penal të Kosovës.

Ky kod parasheh gjobë deri në 7 500 euro ose dënim me burg deri në pesë vjet për armëmbajtje pa leje. Aty parashihet edhe dënim dy deri në dhjetë vjet burg për posedim ilegal të katër ose më shumë armëve ose më shumë se 400 fishekëve.

Sipas kryetarit të Gjykatës Supreme, Enver Peci, Kosovës po i mungon politika ndëshkimore për veprat e armëmbajtjes pa leje. "Dënimet me 200 apo 500 euro për armëmbajtje pa leje nuk kanë logjikë, duhet të ndryshohet politika ndëshkimore për armë. Për mendimin tim, nuk kemi asnjë arsye që një rast me armëmbajtje pa leje të dënohet me të holla, duhet të kalohet në dënime më të ashpra", ka thënë Peci në një deklaratë për REL.

Vrasja e grave nga armët

Armëmbajtja pa leje po kërcënon edhe sigurinë e grave. Në vitin 2020 janë vrarë



gjashtë gra nga burrat e tyre. Rasti i fundit ka ndodhur më 14 mars 2021 kur është vrarë Sebahate Morina, 42-vjeçare, nga ish-burri i saj. Profesori i shkencave të sigurisë, Avni Islami, ka thënë për REL se për vrasjet e tilla që po bëhen duhet të merren hapa urgjentë për largimin e armëve ilegale nga duart e qytetarëve. Sipas Islamit, duhet të bëhet përpjekje shtetërore që të legalizohen armët. "Me këtë identifikohen armët në rast se kryhet ndonjë vepër penale, por edhe gjatë marrjes së lejes për posedim të armës kryhen kurset, aftësohen, dihet si të mirëmbahet arma dhe të ruhet në vende të sigurta për t'i ikur sekondës psikike dhe të në fund aftësohet se arma nuk guxon të përdoret ashtu siç po përdoret tash në disa raste", ka deklaruar ai.

Legalizimi i armëve

Në Ministrinë e Punëve të Brendshme, në një përgjigje dërguar "Radios Evropa e Lirë", thonë se përmes fushatave kanë ndikuar që armët ilegale të legalizohen. Në periudhën e legalizimit nga 17 dhjetori 2018, deri 17 shtator 2019 janë paraqitur rreth 2 000 kërkesa për legalizim të armëve.

MBP-ja thotë se në periudha të tjera të legalizimit presin të kenë më shumë kërkesa për legalizim. Ligji për Armët rregullon kushtet për blerjen, posedimin, armëmbajtjen, ruajtjen, prodhimin, çaktivizimin, riparimin e shumë çështje të tjera. Armët ndahen në kategorinë A, B, C dhe D varësisht prej karakteristikave të tyre, gjatësisë së armës, mekanizmit qitës etj.

Që një person të posedojë armë,

sipas ligjit, duhet të posedojë aftësi të plotë ligjore për veprim, të posedojë aftësi psiko-fizike, të mos paraqesë rrezik për vetveten, për rendin publik dhe sigurinë publike, të ketë të kryer testin teorik dhe praktik për përdorimin e armës e shumë kushte të tjera që përcaktohen me ligj.

Kostoja për legalizim, rreth 300 euro

Sipas Ministrisë së Punëve të Brendshme, janë rreth 16 kompani të cilat merren me trajnimin për përdorim të sigurt të armës. Kostoja totale për legalizim, përfshirë kontrollet shëndetësore, vërtetimet, trajnimin dhe lejen, sipas MPB-së, varion nga 150 deri 250 euro për pistoletë, ndërsa 80 deri 150 euro varion çmimi i trajnimit për armët e gjata për gjueti.

Shpenzimet e tjera për t'u pajisur me armë janë certifikata mjekësore, e cila, sipas MPB-së, ka koston 50 euro sipas një udhëzimi administrative nga Ministria e Shëndetësisë dhe certifikatat e tjera kanë kosto nga 5 euro.

Qendra Kosovare për Studime të Sigurisë në 'Barometrin Kosovar të Sigurisë - Sfidat e sigurisë publike', raport që është publikuar në vitin 2020, kishte theksuar se armëmbajtja pa leje paraqet një rrezik të lartë të sigurisë publike në Kosovë.

Të anketuarit në zonat urbane ishin shprehur më të shqetësuar për këtë dukuri sesa të anketuarit në zonat rurale. Sipas këtij raporti, burrat kishin tendencë të ndihen më të kërcënuar se gratë nga armëmbajtja pa leje.

QKSS-ja u kishte rekomanduar institucioneve se duhen të zotohen për largimin e armëve ilegale nga duart e qytetarëve.

Sot mbahet seanca e radhës ndaj Thaçit, Veselit, Krasniqit dhe Selimit

PRISHTINË, 23 MARS - Gjykata Speciale ka njoftuar se sot (e mërkurë) do të mbahet konferenca e radhës për ecurinë çështjes ndaj ish-kryerëve të UÇK-së. Hashim Thaçi, Kadri Veseli, Jakup



Krasniqi dhe Rexhep Selimi, do të paraqiten në seancën e radhës në gjykatë, duke filluar nga ora 11:00. "Siç është njoftuar në kalendarin tonë të gjykatës, konferenca e radhës për ecurinë e çështjes kundër

Thaçit, Veselit, Selimit dhe Krasniqit do të mbahet më 24 mars, në orën 11:00", thuhet në njoftimin për media. Ish-drejtuessit e UÇK-së akuzohen nga Gjykata Speciale për krime lufte.

Covid-19, lufta e padukshme

- Pandemitë janë rregull, jo përjashtim



Shkruan: Lul RAKA

Mikrobet janë pjesë e pandarë e jetës sonë. Në trupin tonë kemi dhjetë herë më shumë mikroba sesa qeliza tonat. Nga certifikatat e tyre të lindjes, bakteret kanë moshë miliardëshe, kurse viruset nja 300 milionëshe. Janë këtu denbabaden shumë para nesh duke na rikujtuar se pandemitë kanë qenë dhe do të jenë pjesë përbërëse e njerëzimit. Madje, ato kanë qenë rregull, dhe jo përjashtim.

Bota ka hyrë në vitin e dytë të përballjes me një pandemi të paparë nga një virus i padukshëm në formë kurore. Një armik që nuk e shohim me sy edhe pse në një maje të gjilpërës mund të ketë vend për 100 milionë grimca të këtij virusi. Me familjarët e tij u njoftuam që prej vitit 1964 nga një vajzë skoceze. Ato nuk i mori askush aq seriozisht sepse shkaktonin një flamë të zakonshme. Por, në fillim të shekullit të ri, ato bënë kryengritje duke shkaktuar sëmundje të rëndë të mushkërive të cilat i njohëm shkurt si SARS, e më vonë edhe si MERS. Në të dy rastet e epidemive burimi i infeksionit vinte nga kafshët. Lakuriqët, macet, devetë dhe shumë kafshë tjera mbase na tregonin se e kemi tepruar me shkatërrim të shtëpisë sonë - planetit tokë, por ne vazhduam me mospërfillje.

Në lajmet e vitit të ri lexuam për përhapjen e një sëmundjeje nga një virus i paidentifikuar në Vuhan të Kinës. Njerëzimit ia kishte ënda të mendonte se ky problem është larg dhe do të ndalej vetvetiu siç ndodhi herën e parë me SARS-in. Shpejt do të trokiste edhe në dyert e shtëpive tona. Virusi i ri ishte me plot të panjohura dhe na zuri në befasi. Nuk kishim dëgjuar më parë që sëmundjen e përhap dikush që s'ka fare shenja e simptomat të sëmundjes. Aftësia për t'u fshehur i dha këtij virusi një biletë udhëtimi për në mbarë globin.

Origjina e virusit e ndezi zjarrin e konspiracionistëve, sipas të cilëve virusi ishte punëdore që doli nga një laborator virologjik. Shkenca thotë se shfaqja e SARS-CoV-2 ndërlihet edhe me ndryshimet klimatike që ndikuan në shpërndarjen e lakuriqëve në Kinë dhe shtetet përreth. Kërcimi nga lakuriqët tek njerëzit ka të ngjarë të përfshijë një strehues të ndërmjetëm, siç janë disa kafshë që shiten në tregjet e Kinës. Kryesorja, ne virusin e kemi në shtëpi dhe tashmë po përballemi me të duke lënë anash zhurmën e debeteve të origjinës së këtij armiku të padukshëm.

Bota nuk ishte gati

Pandemitë mbjellin frikë, shqetësim e kaos. Kjo sfidon kapacitetet e përballjes dhe menaxhimit të krizës. Bota nuk ishte e përgatitur për një përgjigje të shpejtë e të bashkërenditur. Në vend të bashkëpunimit, superfuqitë kërkonin fajtorin kujdestar në taborë të tjerë. Nuk mësuan nga historia, kur në kulmin e luftës së ftohtë, bashkimi i dy superfuqive për një qëllim shëndetësor arriti që ta zhdukë nga faqja e dheut një sëmundje të rëndë e vdekjeprurëse - linë e madhe, e cila në Evropë së fundi u pa në Kosovën e vitit 1972.

Shtetet që e kishin përjetuar SARS-in në fillimin e shekullit tonë kishin reagim shumë më efikas ndaj pandemisë (Koreja e Jugut, Japonia, Singapori). Popullata e tyre kishte mësuar leksionin e disiplinës parandaluese kundër viruseve, kurse qeveritë kishin investuar shumë në shëndetin publik. Nga bota pamë edhe gjithfarë shembujsh tjerë: disiplinën ushtarake kineze, gatishmërinë milimetrike gjermane, eksperimentet me imunitet të tufës nga Suedia, injorimin e plotë nga Brazili, goditjen e Italisë dhe mungesën e solidaritetit përbrenda shtëpisë së BE-së, karantinimin radikal në Zelandë e Australi, qasjen amerikane me program të mirë por zbatim të keq, kurse pjesa tjetër e botës kishte specifikat e veta dhe përballej me çka kishte në dorë.

Përgjigja ndaj pandemisë ndoshta duket e thjeshtë dhe vlen për çdo sëmundje ngjitesë: diagnostikoni menjëherë, izoloni të sëmurin, gjurmoni kontaktet, testoni dhe menaxhoni rastet e sëmundjes. Kësaj menyje i shtohen edhe koordinimi në të gjitha nivelet, informimi dhe përfshirja e popullit, kontrolli i kufijve, masat parandaluese dhe logjistika. Për dallim prej fletëve të librit, në botën reale secila prej këtyre hallkave është sikur gur Sizifi, që mund të shtrembërojë kurrizin e liderit, punëtorit shëndetësor dhe shëndetin mendor të çdo njeriu.

Kthimi i hipokratit

Pandemia e zhveshi nudo sistemin shëndetësor jetim të Kosovës. Nga paslufta të gjithë vendimmarrësit e kishin gojën plot me shëndetësi, por në tortën e buxhetit shëndetësia ushqehet vetëm me trosha. Fatura erdhi me mungesa në barna, cilësi, kushte dhe besim tek mjeku e mjekësia. Por, pandemia nxori në pah edhe një shtyllë dhe vlerë që i qëndroi stuhisë - punëtorin shëndetësor. Një armatë njerëzish që ktheu besimin tek mantelbardhët dhe tregoi se Hipokrati ende merr frymë në këto treva. Njerëz që i dolën përballë virusit, kur gjithë të

tjerët iknin prej tij. Punëtorë, të cilët për shumë kohë nuk ndjenë ngrohtësinë e përqafimeve të fëmijëve dhe prindërve të tyre. Nuk u ndalën as kur u duartrokitën nga ballkoni, as kur u shanë nga salloni e as kur u grushtuan në vendin e punës. Edhe pse të lodhur e të dërrmuar ata vazhdojnë tutje si marathonomakë. Shumë tjerë iu ngjitën këtij karvani, duke filluar me vullnetarë dhe me të gjithë përfaqësuesit e shërbimeve esenciale në vend. Në këtë betejë pati edhe plot të tjerë që jepnin leksione nga lozhat e ngrohta të kullave të tyre, por tashmë punëtorët shëndetësorë ishin të zënë me punë për të dëgjuar fabulat e tyre.

Sërish vjen marsi

Erdh marsi me rastet e para; me frikë, panik dhe masa restriktive që nuk janë aspak të popullarizuara, por mbrojnë jetë. Karantina ishte përgjigja e parë. Në kohën kur mbylleshin superfuqitë botërore; kur s'kishim teste e pajisje të mjaftueshme mbrojtëse as për punëtorë shëndetësorë; kur virusi kishte shumë të panjohura dhe përhapje nga persona pa asnjë simptomë; kur s'kishte ilaç as vaksinë; kur assesi nuk donim që mjeku të jetë mes dilemës se kush do të futet në respirator e kush do të vdesë në korridor; çfarë zgjedhje tjetër kishim?

Pas lirimit të parë të masave menduam se u kthyem në jetën normale - pa zbatim masash e pa inspektim, por e paguam shtrenjtë. Vjeshta, rihapja e shkollave, kthimi në hapësira të mbyllura e shtuan edhe një valë në lakoren statistikore. Festat e fundvitit e sollën variantin britanik në Kosovë. Ai bashkë me paraardhësin e vet u pritën ngrohtësisht nëpër tubimet partiake zgjedhore e parazgjedhore dhe mund të dalë fitues kryesor i zgjedhjeve. Kjo lëndoi rëndë besimin e ndërsjellë mes popullit dhe prijësve.

Baraspesha mes shëndetit, ekonomisë dhe të drejtave të njeriut ishte shumë e brishtë. Bashkë me shëndetin publik e individual, virusi preku rëndë edhe sofrën e çdo shtëpie dhe shumëzoi pabarazitë e të gjitha ngjyrave. Shumëkush humbi pasurinë, punën, të nesërmen. Këto mund të shprehen me numra. Por, jeta jo. Nuk e ka asnjë çmim. E drejta për jetë është para asaj për lëvizje të lirë bashkë me të gjitha të drejtat tjera simotra. Shëndeti mendor vazhdon të goditet çdo ditë, nga të gjitha drejtimet me fëmijë e gra që bartin barrën më të rëndë.

Long covid, mutacionet e riinfeksionet shpesh godisnin vëmendjen e njerëzve në risitë e Covidit. Në skenën tonë, drama politike që u laujt përbrenda asaj

pandemie ishte një barrë shtesë në kurrizin e punëtorit shëndetësor. Disa dijetarë propozonin "imunitetin e tufës" si model të vetëm të reagimit ndaj pandemisë përmes vetë ekspozimit ndaj virusit. Por harronin se për Kosovën, kjo mund të thoshte deri 12.000 vdekje. Për këta strategë, ata që do merite virusi me vete janë dëme kolaterale të pritshme në çdo pandemi. Nuk ka asnjë sëmundje në histori që ka pasur përgjigje të tillë.

Infodemia

Sjellja e individit në shoqëri është çelësi për të mposhtur virusin. Duke mbrojtur veten, mbrojmë të afërmit dhe vetë njerëzimin. Prandaj, informata e saktë dhe burimet e sigurta të informimit janë qenësore në pandemi dhe fitorja vjen vetëm atëherë kur ta njohësh dhe kuptosh armikun tënd.

Infodemia u quajt pandemia e frikës dhe panikës, të cilat u përhapën shumë më shpejt sesa virusi. Rrjetet sociale ishin ideale për lajme të rrejshme, konspiracion dhe spekulime. Qarkullonin gjithfarë teorish për lluminatin, Bill Gejtsin, OBSH-shejtanin, 5G që kishin një emërues të përbashkët - s'ka virus! Ky numër njerëzish, që kryesisht studiojnë makiaton, nuk është pakicë dhe kundërshton me ngulm "çipat" që do t'ua kontrollojnë mendjet e tyre të ndritura. Logjika e "hajtit" kushtoi me infektim e vdekje të reja.

Përballë tyre janë përplot kryefamiljarë, që me xhepat zbrazët por zemrën plot mbrojtjen familjen duke dëgjuar këshillat për të qëndruar në shtëpi dhe zbatuar treshen e masave parandaluese: distancë, maskë dhe higjienë të duarve.

Të gjitha veprimet e ndërmarra për adresimin e sfidës së Covid-19 duhet të bazohen në shkencë. Te pandemitë, përafrimi mes shkencës e politikës mund të jetë i vështirë. Bota pa plot shembuj bizarë kur krerë shtetesh mohonin sëmundjen, apo sugjeronin përdorimin e varikines për mjekim. Tanët e kanë dëgjuar shumë mirë shkencën, ndonjëherë janë fshehur pas saj e rrallëherë kanë dalë nga orbita shkencore.

Nacionalizmi vaksinal

Vaksina është drita e vetme në fund të tunelit, me të cilën fillon rrugëtimi i gjatë drejt normalitetit. Asgjë në historinë e parandalimit të sëmundjeve nuk pati rol më të madh sesa vaksina dhe sigurimi i ujit të pastër për pije. Në vendet e pazhvilluara, vetëm në 20 vitet e fundit, vaksina shpëtoi 37 milionë jetë njerëzish, kryesisht fëmijë nën pesë vjeç. Xheneri, sikur të udhëtonte sot në kohë, që i bie

diku rreth 225 vite, do të tmerrohej me rrymat e njerëzve që janë ngritur kundër vaksinës. Sot, kur vaksina u gatua me një shpejtësi, po ashtu pandemie, refuzimi i saj përbën kërcënimin më të madh për shëndetësinë dhe njerëzimin. Pabarazitë në sigurimin e vaksinave treguan fytyrën e vërtetë të nacionalizimit të vaksinave, në vend se të ishte internacionalizëm. Japonia, Kanadaja e Australia kanë në total rreth 200 milionë banorë, por kanë rezervuar 1 miliardë doza. Madje, këto tri shtete kanë vetëm 1 për qind të rasteve të Covidit në nivel global. Pjesa tjetër e botës është duke e pritë Godonë. Fatkeqësisht, me këtë qasje, virusi mund të gjej strehues nëpër botë për t'u shumëzuar, ndryshuar petkun dhe vazhduar serialin e pafund të kufizimeve.

Reflektimi në rendin e ri botëror

Pandemia na detyroi të rishikojmë kuptimin tonë për jetën dhe t'i themi vetes "ndalu pak". Të shijojmë detajet e vogla të përditshmërisë, të cilat në shikim të parë na dukeshin të parëndësishme deri sa u ndaluan nga virusi. Të kthehemi kah shenjtëria e dashurisë së familjes, e cila është më e fuqishme se çdo virus. Në kohë pandemie, kur në botë po shumëzohen pabarazitë, kërkohet solidaritet, sidomos për të moshuarit, të pastrehët, të papunët e të varfrit.

Pandemia, paradoksisht, duke ulur aktivitetin industrial pastroi ajrin, lumenjtë, natyrën; zvogëloi aksidentet. Por, gardin e kësaj mbrojtjeje duhet ta mbajmë lart dhe assesi të vazhdojmë të presim pyje, të fusim peshq nëpër gypa, të ndotim lumenjtë, apo ta mbysim të gjelbrën me beton.

Virusi duket se do ta shkruajë rendin e ri botëror. Urgjentisht duhet të shfrytëzohet momentum për investime afatgjata në shëndetin publik. Por, buxheti i ndarë për këtë vit, fatkeqësisht tregoi se të zgjedhurit e popullit nuk e kanë mësuar leksionin. Shëndetësia po vazhdon të ushqehet me trosha. Duhet të ulemi dhe të mësojmë nga gabimet tona që të jemi më të përgatitur për sfidat e radhës. Viruset do t'i kemi këtu edhe nesër e pasnesër. Një tjetër kandidat për "pandemi të qetë" quhet rezistenca antimikrobike. Nëse vazhdojmë me trendin aktual të keqpërdorimit të antibiotikëve, nesër mund të jetë shumë vonë sepse nuk do të kemi me çka të mjekohemi as nga infeksionet më të zakonshme. Në fund do ta mposhtim këtë armik global. Kur po futemi në vitin e dytë të përballjes, do të kujtojmë përjetë çdo pishtar shëndetësor dhe çdo qytetar që humbëm në këtë betejë me Covid-19!

Gordani: Projekti TAP nuk është thjesht një tubacion që sjell gaz

PRISHTINË, 23 MARS - Lorenc Gordani, këshilltar për çështjet e energjisë pranë delegacionit të Bashkimit Evropian, ka thënë se projekti TAP nuk është thjesht një tubacion që sjell gaz, por e kthen Shqipërinë në një qendër furnizimi. Ai ka thënë se kjo jo vetëm që forcon sigurinë energjetike të vendit, por edhe hap mundësi të mëdha investimi duke krijuar zinxhir vlerash për shumë industri. “Me fillimin e operacioneve tregtare të TAP më 15 nëntor 2020, gazi ka arritur në Greqi dhe Bullgari, si dhe në Itali, përmes pikës së ndërlidhjes Melendugno Rete Gas (SRG). Paralelisht po ecet me projektin e Gazsjellësit Jonik Adriatik (IAP) dhe atë midis Shqipërisë - Kosovës. Ka mundësi edhe për impiante të magazinimit të gazit, që mund të lidhen me rrjetin rajonal të gazit dhe Shqipëria mund të sigurojë depo rajonale për vendet e tjera të Ballkanit. Për këto zona interes kanë paraqitur shumë kompani”, ka deklaruar ai.

Gordani ka theksuar se konsumi i gazit natyror në Shqipëri është minimal. “Mund të themi se sot konsumi i gazit natyror në



vendin tonë është në nivelin shumë minimal dhe vjen kryesisht përmes bombolave të gazit dhe përdoret për qëllime industriale, si dhe rrjeti aktual i tubacioneve të gazit prej 498 km, i cili është kryesisht jooperacional. Master Plani i Gazit në Shqipëri, i përgatitur ne

kuadër të finalizimit të projektit TAP parashikon rritjen e konsumit në vend deri në 1.6 bill/m3 deri në vitin 2040. Ky vlerësim kaq optimist mund të fillojë duke thënë se Shqipëria ka një traditë historike në gazin natyror. Konsumi u ul nga 1 bm3 në 1982 në 0,01 bm3 në vitet e

fundit (rreth 77000 m3 në 2019). Numri i përgjithshëm i puseve të gazit të shpuar është mbi 500, por ai aktiv në rreth 20 puse. Sigurisht, zhvillimet e fundit të sektorit të hidrokarbureve në veçanti zbulimi i ‘Shell’-it kanë sjellë në rezerva të reja shoqëruese me naftën”, ka thënë

ai, duke shtuar se zhvillimi i sektorit të gazit natyror është vëlosur tashmë me zgjedhjen midis katër projekteve pretendente të tubacionit Trans Adriatik që transporton gazin e Azerbajxhanit përmes Greqisë dhe Shqipërisë në Itali dhe pjesën tjetër të BE-së.

OAK-u pret bashkëpunim nga qeveria e re me sektorin privat

EPOKA
ERE Albulena S. MAVRAJ

PRISHTINË, 23 MARS - Oda e Afarizmit të Kosovës (OAK) ka kërkuar bashkëpunim të qeverisë së re me sektorin privat, sidomos tani në kohë të pandemisë. “Duke uruar që zhvillimi ekonomik i vendit të jetë prioriteti kryesor, Oda e Afarizmit të Kosovës (OAK) përshëndet konstituimin e Qeverisë së Kosovës në krye kryeministrin Albin Kurti. OAK-u vlerëson se nëpërmjet bashkëpunimit të ngushtë mes komunitetit të biznesit dhe organeve ekzekutive mund të arrihet krijimi i një strategjie të mirëfilltë të zhvillimit ekonomik në vend dhe fuqizimi i sektorit privat, si një nga shtyllat kryesore të ekonomisë, e sidomos gjatë periudhës së vështirë me pandeminë me të cilën po përballemi”, është thënë në komunikatën e OAK-ut. Oda e Afarizmit të Kosovës ka



theksuar se është e hapur për partneritet dhe bashkëpunim të ngushtë me institucionet për klimë shumë më të mirë të të bërit biznes. Edhe Rrjeti i Shitësve me Pakicë ka përgëzuar për

formimin e institucioneve të reja, duke e cilësuar si një hap esencial për fillimin dhe vazhdimin e reformave që mundësojnë trajtimin e çështjeve të cilat kanë penguar fuqizimin dhe zhvillimin e

sektorit privat në përgjithësi, e atë të shitjes me pakicë në veçanti. “Në këtë drejtim, Rrjeti i Shitësve me Pakicë bën thirrje që pa humbur kohë të angazhohen në drejtim të mbështetjes të sektorit privat i

cili dita-ditës po pëson humbje të papërballeshme nga pandemia Covid-19 dhe trajtojnë me prioritet problematikat e bizneseve”, është thënë në komunikatën e Rrjetit të Shitësve me Pakicë.

Gjiganti saudit i naftës “Aramco” raporton rënie të fitimit prej 44-përqindësh



PRISHTINË, 23 MARS - “Saudi Aramco” ka njoftuar se fitimet gjatë vitit 2020 kanë rënë për 44.4 për qind apo

në 49 miliardë dollarë. Gjiganti arab i naftës ka njoftuar se ka fituar 49 miliardë dollarë krahasuar

me 88.2 miliardë dollarë që ishte gjatë vitit 2019. Kompania më e madhe e naftës në botë ka njoftuar se

rënia ishte për shkak të pandemisë Covid-19 që tronditi tregjet e energjisë në botë.

Përsiatje politike / TRIADA E KOSOVËS (14)

Historia është rrotulluar në të mbarë të shqiptarëve



Shkruan: Bedri ISLAMI

Ai u interesua shumë edhe për hartat topografike me të cilat do të përpilohej plani, duke më porositur mua që të shikoj me shumë kujdes hartat që të jenë sa më të reja e të kenë sa më shumë objekte, në të kundërt dërgoni me urgjencë në Austri ose Zvicër. Për këtë Mehmeti shtoi: "Të merrni hartat më të fundit (të reja e me shumë objekte), mos llogarisni çmimin se sa janë!". Më pas shtoi: "Kjo punë kërkon operativitet, iniciativë dhe marrje përgjegjësie mbi vete, e mos u mbytni me një pikë uji!". Pra, si duket, ai (M.SH) kishte menduar e punuar tërë natën dhe të nesërmen na i komunikoi në këto detyra. Për problemin e hartave, u konsultova me shefin e Degës së Topografisë në Ministrinë e Mbrojtjes shokun Limoz Alimucaj dhe drejtorin e Institutit të Topografisë shokun Përparim Likaj. Mbasi i kërkoj hartat për një studim të hollësishëm të terrenit, në trojet etnike shqiptare (Mali i Zi-Kosovë-Maqedoni), pa u treguar qëllimin e vërtetë pse i doja, ata më rekomantuan, sipas të dhënave që kishin, se harta të tilla me objekte të sakta e të imtësishme kishte kryesisht në Austri. Atëherë bisedova me Përparim Likën dhe ai u dërgua në Zvicër për blerjen e këtyre

hartave, i shoqëruar nga një punonjës i Ministrisë së Punëve të Jashtme, pjesëtar i zbulimit të jashtëm. Këto harta u blenë me ato çmime që afruan austriakët. U sollën në Shqipëri, u përgatitën nga grupi përkatës i Institutit të Topografisë dhe iu dhanë Shtabit të Përgjithshëm në përdorim. Pra, plani i ndërhyrjes ushtarake në Kosovë, i quajtur "Shpërthimi", u përgatit mbi bazën e këtyre hartave që kishin të dhëna të hollësishme të terrenit dhe objekteve përkatëse.

Kjo është një dëshmi, e pas më shumë se 24 vjetëve, e ish-shefit të Shtabit të Përgjithshëm të Ushtrisë Shqiptare. Nuk mund ta vlerësoj autencitetin e këtyre ngjarjeve. Është fakt se, në shtypin shqiptar në Tiranë, ku edhe u botua intervista e tij, nuk kishte kundërshtime për vërtetësinë e planit, por debati u përqendrua më shumë, megjithëse në fare pak kohë, në utopinë e një plani të tillë. Mirëpo, diçka tjetër është padyshim e vërtetë dhe kjo është tashmë e njohur. Në veriun e Shqipërisë, pak para ngjarjeve të vitit 1981 dhe me më shumë ngut pas tyre, u ngritën depo të mëdha armatimi, për rreth 30 mijë ushtarë, me të gjitha mjetet e duhura logjistike, që nga pajisjet më të thjeshta dhe deri tek armatimi i rëndë. Çdo gjë ishte e siguruar, përmes kanaleve të ndryshme, në shtetet perëndimore. Logjistika ishte përgjithësisht angleze dhe e destinuar për një luftë në Kosovë. Çdo gjë që ndodhej në

këto depo, më vonë, u shit, ashtu si është publikuar, me çmime qesharake, nga zoti Zhulali, diku në Afrikë apo tek serbët e Bosnjës.

Ndoshta EH, në vitin 1981, kishte menduar se, me anë të një lufte në Kosovë, qoftë edhe utopike, mund të shmangte vështirësitë e vendit të tij, mirëpo një logjikë e tillë nuk më duket e arsyeshme. Nëse shteti shqiptar, 40 vite më parë do të niste një luftë të tillë do ishte e vështirë, në mos e pamundur, që të mos përballej edhe reagimin e ashpër të shteteve europereëndimore. 17 vjet pas ngjarjeve të marsit 1981, përsëri në mars, kur lufta në Kosovë nisi, megjithëse shteti shqiptar nuk i hapi depot, përsëri ai u vu nën vëzhgim ndërkombëtar. Mundësinë e shmangies së problemeve në një krahinë shqiptare me tjetrën, gjithnjë sipas mendimit tim, unë e përjashtoj. Duke njohur deri diku psikologjinë, karakterin dhe filozofinë politike të EH dhe ndihmësve të tij më të afërt, shpeshherë shumëfish më ekspressive, si Hysni Kapo dhe Mehmet Shehu, nuk e kishin zakon të pyesnin për gjëra të tilla dhe as të bëheshin merak se çfarë thoshin rreth tyre. Këtë EH nuk e kishte pasur edhe shumë vite më herët, nuk do e kishte deri në fund të jetës së tij, duke kthyer, me dhimbje e dhunë, vendit të tij në një fortesë, ku mund të rrije anktshëm brenda, por nuk mund të dilje jashtë.

Shteti shqiptar, e për këtë jam i bindur, ka synuar gjithnjë, që përmes mërgatës shqiptare të Kosovës dhe të viseve të tjera në Jugosllavi, të ndikonte tek

njerëzit. Nuk e përjashtoj që përmes ambasadave shqiptare në shtetet perëndimore, sidomos në Zvicër dhe në Austri, janë bërë të gjitha përpjekjet për të pasur lidhje të vazhdueshme me lëvizjet ilegale. Nga ana tjetër, edhe ilegalët që ishin jashtë Kosovës, e kërkonin dhe e donin këtë lidhje, e cila, asnjëherë, nuk ka qenë një lidhje agenturore, për interes, edhe kur, mes tyre, janë vendosur strukturat e fshehta. Në fund të fundit, shqiptarët në perëndim kishin dy ambasada ku mund të shkonin, tek ajo e Beogradit dhe tek ajo e Tiranës. Në fundin e viteve '80-ta mërgata shqiptare e Kosovës merr një hop të ri cilësor, por, e kam të vështirë të besoj se, përmes tyre, shteti shqiptar ka ndikuar në zhvillimin e demonstratave të marsit 1981, dhe sidomos të atyre të 11 marsit. Në faktin që më vonë, sidomos më 26 mars, këto demonstrime morën karakter të theksuar kombëtar dhe politik, ka ndikim mendimi politik i mërgatës shqiptare, e përmes saj, edhe shteti shqiptar. Në demonstratat e vitit 1981 kishte shumë parulla politike, mes të cilave, më e rëndësishmja dhe më sunduesja ishte, "Kosova Republikë". Po të vëresh me kujdes qëndrimin e shtetit shqiptar ndaj parullave të hedhura, do të vëresh se, ndërsa u pajtua dhe mbështeti fuqishëm kërkesën për Republikën e Kosovës, ai nuk u prononcua për bashkimin kombëtar. Në asnjë nga materialet bazë të qëndrimit të shtetit shqiptar, nuk është mbështetur haptazi një parullë


e tillë, me përjashtimin e një citimi në artikullin e fundit, në të cilin aludimet bëhen shumë konkrete.

Do të doja të përmbyllja këto shënime, me preciozitetin shumë të lartë që u ka bërë ngjarjeve të pranverës së vitit 1981, studiuesi dhe, njëkohësisht, një prej miqve dhe mbështetësve më të mëdhenj të lirisë së Kosovës dhe të Ushtrisë së saj Çlirimtare, profesor Shaban Sinani.

Shqiptarët qenë të parët që i treguan botës se "federalizmi shumëkatësh" i këtyre vendeve nuk funksiononte si propagandohej, sepse liria dhe mirëqenia e një pale sigurohej në kurriz të nënçmimit dhe shfrytëzimit të palës tjetër. Kosova i tha kësaj bote se çështjet nacionale ende nuk janë futur në arkiv dhe nuk mund të mbahen gjatë tabu. Heronjtë e asaj kohe dhe sfida e tyre janë në nderin e historisë shqiptare. Tek kjo sfidë historia do të rikthehet shpesh. Ne e dimë se historia rrotullohet ngadalë, por kurdoherë që fati i shqiptarëve do të jetë afër mbarësisë, kurdoherë që cikli i historisë do të rikthehet aty ku çështja mbeti në vitet '80-ta, protagonistët e saj do të çmohen. ("Zëri i Kosovës", 15. 04.1996).

Kaq vite pas këtyre ngjarjeve epike historia është rrotulluar në të mbarë të shqiptarëve. Ata kanë shansin e tyre të madh që të bëhen pjesë e historisë së vendit dhe kombit të tyre, nëse nuk do të harrojnë se, deri këtu, është dashur një përkushtim i disa brezave, të cilin, nuk mund ta nëpërkëmbin pinjollët e një skote të namun. **(Fund)**





QENDRA SPORTIVE
'BUJQËSIA'
TEL: 045/82 82 82

FFK-ja zbulon logon e re dhe fanellat e reja të përfaqësueses

PRISHTINË, 23 MARS - Federata e Futbollit e Kosovës ka bërë të martën prezantimin e logos së re si dhe fanellat e reja të Përfaqësueses së Kosovës për ciklin e ri kualifikues. Detajet rreth logos së re dhe të fanellave në konferencën për media i dhanë Bakir Burri, nënkryetar, Alba Morina nga zyra e marketingut dhe Lulzim Berisha, kryetar i grupit të tifozëve "dardanët". Në fakt, FFK-ja me kërkesë të UEFA-së dhe me vullnetin e pajtueshmërinë e plotë të presidentit Agim Ademi, sekretarit të përgjithshëm, Eroll Salihu, komitetit ekzekutiv dhe tifozëve dardanët e ka filluar procesin e ribrendimit.

Nënkryetari Bakir Burri theksoi se FFK-ja logon e re e ka cilësuar të qëlluar pasi në të janë përfshirë simbolet tona të lashta. "Dëshiroj që kjo emblemë të pëlqehet nga të gjithë. Neve si federatë na ka pëlqyer dhe është e qëlluar pasi i ka simbolet tona. Shpresoj se me këtë emblemë dhe fanellat e reja të kemi fat në këto kualifikime",

ka thënë ai.

Edhe kryetari i tifogrupit "dardanët", Lulzim Berisha, theksoi se logoja e re është bërë në koordinim me ta dhe janë të lumtur që simboli dardan është pjesë e logos. Në anën tjetër, Alba Morina ka dhënë detaje mbi procesin e ribrendimit. "Puna e ribrendimit i është besuar partnerit të UEFA-së, i cili deri më tani kanë punuar logot e 28 federatave anekënd botës dhe kjo është një dhuratë nga UEFA për FFK-në. Përfaqësuesja e Kosovës tashmë është simbol i krenarisë së këtij vendi, ndërsa Federata e Futbollit e Kosovës është shndërruar në forcën unifikuese të shqiptarëve, në forcën pozitive që si mision ka ta mbrojë, ta zhvillojë e ta promovojë futbollin kosovar. Andaj FFK dhe presidenti Ademi janë të vendosur të jenë të bashkuar, të hapin mundësi dhe të shërbejnë me integritet e dinjitet", ka thënë Morina.

Ajo më tutje ka bërë me dije se forma e logos është e inspiruar në mburojën dardane, që tregon fuqinë që populli ynë ka për t'i



mbrojtur vlerat e veta, derisa si simbole të kësaj logoje janë përdorur Dielli Dardan, që simbolizon fillimet e mundësive të reja, trimërinë, ngrohtësinë e fuqinë, energjinë pozitive dhe besimin në vete e që ndërlihen me vlerat që prezanton FFK, integriteti, nderi, uniteti dhe ngritja e futbollit. Yjet e flamurit të Kosovës dhe topi i futbollit si forca më pozitive e historisë ndër vite, që nga sakrificat e deri të shkëlqimi ditëve të sotme.

Muriqi përjashtohet nga përfaqësuesja

FFK-ja ka njoftuar se portieri i Përfaqësueses së Kosovës, Arijanet Muriq, është përjashtuar nga kampi i ekipit përfaqësueses. Kjo është bërë me dije përmes një komunikate të lëshuar nga FFK-ja. "Me vendim të Federatës së Futbollit të Kosovës, futbollisti Arijanet Muriq largohet nga kampi i ekipit përfaqësues për arsye disiplinore", thuhej në njoftim. Kosova kështu humb portierin e parë në këto ndeshje, teksa në dispozicion i ka edhe tre të tjerë. Samir Ujkani, Visar Bekaj dhe Betim Halimi janë portierët e tjerë të "dardanëve".

Prishtina - Llapi dhe Istogu - Dukagjini përballen në gjysmëfinale të Kupës



PRISHTINË, 23 MARS - Janë mësuar çiftet e ndeshjeve gjysmëfinale të Kupës së Kosovës në futboll në shortin e tërhequr të martën në stadiumin "Fadil Vokrri" të Prishtinës. Shorti ka përcaktuar që në gjysmëfinale, të përballen Istogu - Dukagjini

dhe Prishtina - Llapi. Në këtë raund finalist do të përcaktohet pas dy ndeshjeve. Ndeshjet e para do të zhvillohen më 7 prill, kurse ato të kthimit më 21 prill. Pas shortit, trajneri i Prishtinës, Zekirija Ramadani, tha se nuk kishin fat në shortin e Kupës që

nga fillimi e deri tash. "Nuk kemi pasur fat aspak në shortin e Kupës që nga fillimi i saj e ku gjithmonë na kanë rënë ekipet më të forta të secilit rund, duke filluar prej 1/8 me Dritën, në çerekfinale me Feronikelin dhe tashti në gjysmëfinale me Llapi. Vlerësim maksimal për

Llapi si ekip. E dimë që objektivi i dy skuadrave është kupa, por është mirë që luhet me dy ndeshje dhe të shpresojmë që edhe këtë pengesë të vështirë ta kalojmë për të dalë në finale", ka thënë Ramadani për faqen e Prishtinës.

Hysaj: Ta nisim me këmbën e mbarë ndaj Andorrës

TIRANË, 23 MARS - Në konferencën e radhës për shtyp të Kombëtares kuqezi para ndeshjes me Andorrën ishte Elseid Hysaj. Mbrojtësi i Napolit në fjalën e tij theksoi rëndësinë për t'i nisur mbarë eliminoret e Botërorit. "Ta fillojmë me këmbën e mbarë, ndeshjet e para janë më të rëndësishme. Të jemi kompaktë si në ndeshjet e fundit në Nations League. Duhet ta nisim mbarë me

Andorrën. Kemi shumë lojtarë me minutazh të madh dhe formë të mirë. Jemi një grup fantastik, lojtarë si Bajrami mund të na japin një dorë më shumë. Është më mirë kur e njeh një kundërshtar. Janë lojtarë që dinë të luajnë futboll. Duhet të jemi të përqendruar dhe ta bëjmë ndeshjen e lehtë për të mos pasur probleme", ka thënë Hysaj. "Kalendari i ngjeshur? Jemi mësuar, edhe ne po luajmë çdo tri ditë. U

bë një vjet që po luajmë në këto kushte. Nuk do të jetë problem për asnjë nga lojtarët. Edicioni i ri? Nuk ka ndryshime, jemi i njëjti grup, pak a shumë. Treguam që po luajmë futboll të mirë, na eci mbarë. Duhet të kemi pak nga fryma e kaluar dhe pak nga e reja me Bajramin dhe të tjerët. Jemi adaptuar dhe kemi marrë vesh si duhet të lëvizim në fushë. Në fillim ishte rrëmujë dhe nuk po kuptonim lëvizjet. Nuk ka



kohë skuadra të stërvitet 100 për qind. Duhet të kemi besim te trajneri dhe ai te

ne. E kemi kuptuar skemën dhe jemi duke ecur mirë", ka shtuar Hysaj.

Bale: Plani im është i qartë, do të kthehem në Real Madrid në verë

Gareth Bale e ka bërë të qartë se do të kthehet në Real Madrid sapo të përfundojë huazimi i tij në Tottenham në qershorin e kësaj vere. Anësori 31-vjeçar, i cili ka marrëveshje me Real

Madridin deri në verën e vitit 2022, i ka bërë 25 paraqitje për Tottenhamin deri tani këtë sezon, duke i shënuar 10 gola dhe duke i dhuruar tri asistime. Por Bale ka dështuar ta zërë vendin e titullarit në

skuadrën e Jose Mourinhos dhe kthimi i tij i përhershëm në Londrën e veriut nuk duket i mundshëm, gjë që edhe ai vetë e ka pranuar. “Nuk më shpërquendron para Euro 2020”, tha Bale për të

ardhmen e vet të pasigurt. “Plani im gjithmonë ka qenë ta bëj një sezon në Spurs, e pastaj të kthehem në Madrid pasi e kam edhe një vit në marrëveshje. Kaq gjatë kam planifikuar, të jem i sinqertë”, shtoi ai.



Transformimi i logos së FFK-së: Nga ajo kuq e zi me shqiponjë e deri më sot

Logoja që Federata e Futbollit e Kosovës prezantoi sot në konferencë për media është e pesta që nga viti 2000.

Logoja e re përbëhet nga tri ngjyra, ari, bardh dhe kaltër, me këtë të fundit që dominon. Me inicialet e federatës (FFK) të vendosura në kokë dhe gjashtë yjet e flamurit të Kosovës, që përfaqësojnë pakicat në vend, nën të, logoja përmban edhe një simbol dardan në formë rrethi që FFK e quajti Dielli Dardan, si dhe topin e futbollit. Në vitin 2000, logoja e FFK-së ishte krejtësisht ndryshe. Ajo përmbante shqiponjën, inicialet e FFK-së dhe një top të futbollit bashkë me fjalën Kosova.

Më pas ajo u ndryshua në vitin 2006, duke iu hequr shqiponja, por megjithatë mbizotëroi ngjyra e kuqe, me shkronjat e zeza.

Në vitin 2008, FFK ndryshoi komplet



ngjyrën, duke vënë theksin tani mbi ngjyrën e kaltër.

10 vite më vonë ajo u ndryshua, teksa mbeti në përdorim për pothuajse tri vite, deri sot kur u prezantua logoja e

re.

Përveç logos, FFK sot prezantoi edhe fanellat e reja të “Dardanëve” për ndeshjet kualifikuese për Botërorin 2022.

SHKURT

Prandelli jep dorëheqje si trajner i Fiorentinës

Fiorentina ka njoftuar zyrtarisht se Cesare Prandelli ka dhënë dorëheqje si trajner i Viola për arsye që shkojnë përtej futbollit. Trajneri i Violas ishte kthyer në Artemio Franchi në nëntor të vitit të kaluar, por 63-vjeçari ka vendosur të tërhiqet vetëm gjashtë muaj më vonë.

“ACF Fiorentina mund të konfirmojë që Cesare Prandelli ka dhënë dorëheqje si trajner i Fiorentina”, shkroi klubi në një deklaratë.

Prandelli ofroi dorëheqjen të martën dhe – me shumë trishtim – klubi ka pranuar vendimin e tij, duke pranuar se arsyet pas kësaj shkojnë përtej futbollit.

Gjatë muajve të fundit, Prandelli ka dhënë gjithçka si trajner, duke treguar edhe një herë lidhjen e thellë që e lidh atë me Fiorentina dhe qytetin e Firences.

Sky Sport Italia shkruan se trajneri pranoi se karriera e tij si trajner mund të përfundojë këtu.

“Unë jam i vetëdijshëm që karriera ime e trajnerit mund të përfundojë këtu, por unë nuk jam penduar”, tha Prandelli.

“Ndoshta, kjo botë që unë kam qenë pjesë e gjithë jetës sime nuk është më për mua dhe nuk e njoh më veten në të. Unë kam ndryshuar, me siguri, dhe bota shkon më shpejt sesa mendoja”, theksoi ai.

Haaland e konfirmon të ardhmen

Erling Haaland nuk brengoset për thashethemet se ai do të largohet nga Borussia Dortmund për një shumë të majme parash në verë, duke e parë interesimin e madh që klubet kryesore evropiane kanë shfaqur për të.

Sulmuesi 20-vjeçar është njëri prej futbollistëve me të ardhmen më të ndritur në futbollin evropian dhe thuhet se Real Madridi, Barcelona dhe Manchester City janë të gatshme të shpenzojnë bujshëm për shërbimet e tij.

Por Haaland thotë se do të vazhdojë të mos ua veshin thashethemeve për të ardhmen e tij dhe se do të përqendrohet te Dortmundi.

Haaland po shijon formë mahnitës, pasi i ka shënuar 49 gola në 49 paraqitje për Dortmundin që prej transferimit nga Red Bull Salzburg në janar të vitit 2020.

Utah Jazz, lider në Perëndim, fitojnë edhe Clippersi e Bukcsi

CHICAGO, 23 MARS - Utah Jazz konsolidon kreun e renditjes në Konferencën e Perëndimit pas fitores 120-95 ndaj Chicagos, ndeshje e dominuar nga miqtë. Mitchell realizoi 30 pikë, mbështetur edhe nga Gobert me 21 pikë e 10 rebounde. Pa probleme fiton edhe Milwaukee, që ndodhet mes ekipeve kryesuese në Lindje. Ekipi i Bucksit mposhti 140-113 Indiana, takim ku nuk ndikoi aspak mungesa e Giannis Antetokounmpo te vendasit. Ai u zëvendësua më së miri nga Holiday (28 pikë e 14 asistime) e Middletoni (25 pikë). Fitore në sekondat e



fundit korri Charlotte, që mundi 100-97 San Antonio (Hayward 27 pikë). Pas 8 fitoresh radhazi ndalet skuadra e Atlanta, që u mund 119-100 nga Clippersi, një ndeshje me rivalitet. Leonard realizoi 25 pikë

për kalifornianët, ndërkohë që 52 pikë u realizuan nga lojtarët e stolit. Shpreson për një vend në play off ekipi i Memphisit, që mundi Bostonin 132-126 (Morant, 29 pikë).

REZULTATET

Cleveland - Sacramento	105-119
Minnesota - Oklahoma	103-112
San Antonio - Charlotte	97-100
Chicago - Utah Jazz	95-120
Houston - Toronto	117-99
Memphis - Boston	132-126
Milwaukee - Indiana	140-113
Clippers - Atlanta	119-110

Vdes ish-sulmuesi i Anglisë

Ish-sulmuesi i Anglisë dhe Leicester City, Frank Worthington, ka vdekur sot në moshën 72-vjeçare pas një sëmundjeje të gjatë, ka njoftuar familja e tij.

Worthington luajti për më shumë se 20 klube, përfshirë Huddersfield, Leicester dhe Bolton, gjatë karrierës së tij të gjatë nga viti 1966 deri më 1991. Ai luajti për Anglinë në vitin

1974, duke i shënuar dy gola. Familja e tij njoftoi se ai vdiq paqësisht në spital të hënën.

Bashkëshortja e tij, Carol,

tha: “Frank u solli lumturi shumë njerëzve gjatë karrierës së tij dhe në jetën e vet private. Ai do t’iu mungojë të gjithë atyre që e deshën aq shumë”.





KOMPANIA REGJIONALE E MBETURINAVE "UNITETI" SH.A MITROVICË

Duke u bazuar në nenin 7 dhe 8 të Ligjit të Punës (Ligji Nr.03L/212), Vendimit të Bordit të datës 19.11.2020 për shpalljen e konkurseve, gjendjes momentale dhe nevojave të Kompanisë për plotësimin e vendeve të punës për periudhën e ardhshme një vjeqare, KRM "Uniteti" SH.A vendosi që me datë 23.03.2021 të rishpallë:

KONKURS PUBLIK

Për plotësimin e vendit të punës:

Një (1) Punëtor Fizik -Njësia në Skenderaj me kohë të caktuar (me kohëzgjatje 1/një vjeqare), me mundësi vazhdimi

Detyrat kryesore dhe përgjegjësitë:

- Kryen të gjitha punët në mbledhjen dhe ngarkimin e mbeturinave në automjete – kamion kompaktor dhe traktor,
- Zbrazen e konteinerëve dhe pastrimin e lokacionit rreth tyre nga zona e shërbimit gjerë në deponi.
- Kryen pastrimin, larjen dhe spërkatjen e sipërfaqeve publike, rrugëve dhe shesheve.
- Kryen punët e grumbullimit të mbeturinave në konteiner, kryen punët rreth pastrimit të borës, hedhjes së kripës industriale, heqjen e akullit,
- Është i obliguar të ketë sjellje korrekte ndaj qytetarëve dhe shfrytëzuesve të shërbimeve.
- Është përgjegjës për përdorim të kujdesshëm të konteinerëve gjatë punës, kryen edhe punë tjera të natyrës së ngjajshme të cilat i cakton udhëheqësi i tij i drejtëpërdrejtë.

Kualifikimet e kërkuara:

- Të ketë shkollën fillore ose së paku një vit përvojë pune;
- Të prezantoj leternjoftimin;
- Çertifikatë nga gjykata se nuk jeni i denuar (më e re se 6 muaj);
- Çertifikatë mjeksore (me rastin e lidhjes së kontratës).

Kushtet e veçanta:

Punëtori gjashtë (6) muajt e parë do të jetë në punë provuese, dhe varësisht nga performanca e tij do ti vazhdohet apo përtrihet kontrata e punës.

Aplikacionin së bashku me diplomën, referencat etj. mundë të dorëzohen në Zyrën e Arkivës, në Kompaninë Regjionale të Mbeturinave "Uniteti" Sh.A. Mitrovicë. Konkursi do të jetë i hapur pesëmbëdhjetë (15) ditë nga dita e publikimit në gazetën ditore prej 23.03.2021 deri më datën 07.04.2021. Kërkesat e dorëzuara pas afatit dhe të pakompletuara me dokumentacione përkatëse, nuk do të merren për shqyrtim nga ana e Komisionit Vlerësues. Vlerësimi formal dhe intervista do të bëhet pas përfundimit të afatit të aplikimit.

NJOFTIM

Njoftojmë të gjithë klientët se "CEYOND CEE" SH.P.K. me pronar Abedin Matoshi ka marrë vendim të shuaj biznesin me nr. 811302322 dhe ka caktuar likuidatorin për zhvillimin e procedurës së Likuidimit. Njoftohen të gjithë klientët që kanë raporte Kreditore - Debitorë në këtë korporatë që të paraqiten në afatin 30 ditor nga data e shpalljes në gazetë.

OBAVESTENJE

Obavestavanje se svi klienti da drustvo sa "CEYOND CEE" D.O.O. Abedin Matoshi donelo odluku o prestani rada sa nr. 811302322, ujedno imenovao Likvidatora o sprovođenju postupka likvidacije. Obavestavaju se svi klienti koji imaju obaveze i potraživanja u navedenoj firmi, da se jave u roku od 30 dana od dana objavljivanja o novine.

ANNOUNCEMENT

All clients are to be informed that the "CEYOND CEE" L.L.C. Abedin Matoshi has come to the decision to quit its nr. 811302322, the company has appointed a liquidator who is going to oversee the liquidator process. All clients who have the mortgage – mortgage accounts in this company are kindly request to show up within 30 days starting from the day of newspaper announcement- publication.

Prallëherë ndodh që lexuesi, pasi ta ketë lexuar librin, të marrë informacion, të gjejë thellësi mendimi, shqyrtim profesional dhe njerëzor të një krijimtari filmike sikurse i merr dhe i gjen në librin e Agron Shalës. Njëjtë si Kieślowski që i linte të hapura veprat e tij, Shala nuk pretendon të mbyllë asgjë por, duke shqyrtuar në dimensionin artistik, politik, fetar e njerëzor, hap mundësi të reja interpretimi për dekalogun e ditëve tona.

Zymer Kelmendi

Ky libër është interpretim për dramën serike "Dekalogu" të regjisorit Krzysztof Kieślowski, i ndërthurur me një egzgjenezë të lirë autoriale të veprave të kulturave të lashta, ku nuk mungojnë as analiza psikologjike e etike që lidhen me karakteret dhe veprimet e protagonistëve të dramës, por edhe me jetën dhe besimin e shqiptarëve sot. Një libër i shkruar me një gjuhë të rrjedhshme, që me çdo fjali të shtyn ta lexosh më tutje. Konsideroj se ky libër përbën një kontribut të pasur shkencor në opusin e kritikës së veprave artistike.

Kristë Shtufi

Një libër që zbrërthen relacionet e njeriut me fenë dhe Zotin, që bazohet në një vepër filmike, por që përçohet te ne nëpërmjet urdhrave biblike. Autori në mënyrë të mprehtë dhe me delikatesë e ndërldh temën e besimit në Zot, ekzistencën e religjioneve të shqiptarët, duke bërë ndarjen mes fesë dhe identitetit kombëtar. Shkurt, ky është një libër i shkruar me kujdes, me një gjuhë të pastër dhe krejtësisht intelektuale, e që do të duhej të lexohej nga secili.

Fadil Sahiti

... përmes mikrobotës së Kieślowskit, "Dekalogu" i Agron Shalës na dëshmon se mund të ringjallet metamorfoza progresive e mendjes tonë...

Orhan Kerkezi

Kur shikohet "Dekalogu" i Kieślowskit dhe kur lexohet libri i Shalës, kuptohet thënia se 'thjeshtësia është madhështi'.

Daut Dauti

ÇMIMI: 5.99 €



DEKALOGU
nga Moisiu deri te Kieślowski

AGRON SHALA | DEKALOGU | NGA MOISIU DERI TE KIEŚLÓWSKI

AGRON SHALA



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
OIK

Oda e infermierëve, mamive dhe profesionistëve tjerë shëndetësor të Kosovës
Komora medicinskoh sestara, babica i ostalih zdravstvenih stručnjaka Kosova
The Kosovo Chamber of nurses, midwives and other health professional



Në bazë të nenit 8 të Ligjit të Punës Nr. 03/L-212, Udhëzimit Administrativ Nr.07/2017 për Rregullimin e Procedurave për Themelimin e Marrëdhënies së Punës në Sektorin Publik. Në bazë të nenit 20 pika 1.6 të Ligjit për Odat e Profesionistëve Shëndetësor Nr.04/L-150, nenit 23 pika 1.6 të Statutit të OIK-ut, dhe mbështetur në Rregulloren për Sistematizimin e Vendeve të Punës të Shërbimit Profesional të OIK, me Nr.Prot.55/2 të datës 13.02.2018 Oda e Infermierëve të Kosovës shpallë këtë:

KONKURS

Për këtë pozitë të punës:

I. Titulli i vendit të punës: Udhëheqës i Zyrës për Edukim të Vazhdueshëm Profesional

Norma e punës: Orar i plotë (40 orë pune në javë)
Kontrata: Me periudhë të caktuar
Raporton: Kryetarit të OIK-ut
Nr. i zyrtarëve: Një (1) Pozitë.

Përshkrimi i detyrave të punës:

- Kordinon punën e zyrës
- Mbikqyrë në baza ditore realizimin e punëve të zyrës
- Asiston dhe jep ndihmë komisioneve përkatëse
- Harton planin e zyrës
- Përgatit raportet mujore, tremujore, dhe vjetore të zyrës
- Inicion te organet e Odës propozimet për ndryshimet dhe plotësimin e akteve normative nga fusha përkatëse
- Bashkëpunon me njësit tjera organizative të shërbimit profesional dhe administrativ në çështjet e veprimeve të lidhura me procedurat e Edukimit të Vazhdueshëm Profesional
- Përgatit dhe nxjerr aktet e miratuara në Komisionin përkatëse
- Mbanë evidencë për pjesëmarrje në takimet e Komisioneve dhe i procedon ato në njësitë përkatëse tjera organizative të Odës
- Kryen dhe punë tjera sipas kërkesës së Kryetarit dhe Sekretarit të Përgjithshëm të Odës
- I përgjigjet Sekretarit të Përgjithshëm të Odës
- Është përgjegjës për mbarëvajtjen e punës së zyrës
- Mbikqyrë punën e zyrtarëve të zyrës
- Kujdeset për ligjshmërinë e punës së Zyrës
- Ngritë çështjet e nevojës së draftimit të akteve normative në lëmitë që i përkasinë fushës së përgjegjësisë të zyrës
- Kryen dhe punë të tjera zyrtare sipas kërkesave të udhëheqësit.

Shkollimi i kërkuar:

- ✓ Diploma e Fakultetit Universitar
- ✓ 2 (dy) vite përvojë pune.

Dokumentacioni i nevojshëm për aplikim:

- ✓ Diploma e Fakultetit Universitar
- ✓ Dokumenti i identifikimit (Letërnjoftimi) kopje.
- ✓ Dëshmi për përvojën e punës.

Aftësitë / përvoja dhe atributet e tjera që kërkohen:

- ✓ Të ketë shkathtësi të dëshmuara dhe efektive të komunikimit me shkrim dhe me gojë,
- ✓ Të ketë njohuri të gjuhëve zyrtare në përdorim;
- ✓ Njohja e punës me kompjuter është e domosdoshme.

Kushtet e pjesëmarrjes në konkurës:

Të drejtë aplikimi kanë të gjithë shtetasit e Republikës së Kosovës të moshës madhore të cilët kanë zotësi të plotë për të vepruar, si dhe të ketë aftësinë profesionale për kryerjen e detyrave.

Procedurat e konkurrimit: Konkurrimi është i hapur për të gjithë kandidatët e interesuar.

Data e mbylljes së konkursit: 15 ditë nga data e publikimit në mjetet e informimit.

Paraqitja e kërkesave: Aplikacionet merren, plotësohet, dhe dorëzohen çdo ditë pune nga ora 09:00-14:00 në zyrën e OIK-ut.

Adresa: Rruga "Holger Pedersen" mbrapa QKUK-së kompleksi banesor Vëllezërit Asllani.


Të gjitha dokumentet dhe dëshmitë profesionale t'i bashkëngjiten aplikacionit.

Aplikacionet e dërguara pas datës së mbylljes së konkursit dhe kërkesat e pa kompletuara nuk do të pranohen.

Kandidatët të cilët aplikojnë, të ofrojnë dëshmitë sipas konkursit të shpallur, për ndryshe kandidatët që nuk i plotësojnë kushtet e konkursit nuk do të thirren për intervistim.



Prishtinë,
Datë: 23.03.2021



Gjej PUNË

- Lajme nga tregu i punes
- Shërbime shkrimi

Gjej Punë ofron shërbime drejtë përgaditjes së:

- CV-së
- Letrën Motivuese
- Parapregaditje për intervistë



www.facebook.com/gjejpuneshpejte

RESTAURANT

SWISS

TAVERNA

Tel: +377 45 400 156

+386 49 848 553

PRISHTINË

>> SHPALLJE TË VOGLA <<

► Bujar Gashi shpall të pavlefshme dëftesat dhe diplomën SHMLT "11 Marsi" në Prizren.

► Ismet Tairi shpall të pavlefshme diplomën e Shkollës së Mesme "Alauddin" në Prizren.

► Halim Lushaj shpall të pavlefshme diplomën SHME "Ymer Prizreni" në Prizren.

► Nexhat Braha shpall të pavlefshme dëftesat diplomën, certifikatën shtetërore SHMLT "11 Marsi" në Prizren.

► Sejfulla Krasniqi shpall të pavlefshme diplomën SHMLT "11 Marsi" në Prizren.

► "Poligoni Spartan" SH.P.K. shpall te pavlefshme certifikaten e biznesit me nr. 810070631.

► Valdete Gërzhelihu shpall të pavlefshme Diplomën e Shkollës së Mesme të Mjekësisë "Dr Xheladin Deda" në Mitrovicë.

► Bashkim Meha shpalle te palvefshme diplomen e kolegjit AAB,drejtimi Menaxhmet dhe Informatik.

► Antigona Meha shpalle te pavlefshme diplomen e kolegjit AAb , drejtimi Perkujudesje dhe mireqenie per Femije

► Jap banesë me qira afër 60 m2, kati III-Lagja Mati 1 Rr.Zi-Si Theodor Muzaka nr.14. në Prishtinë. Banesa posedon dhoma gjumi dhe sallon, kuzhinë, korridor banjo ballkon . Banesa është e mobiluar komplet, preferoj ta jap banesën me qira për afat të gjatë. Tel: +38344185233.

► Lëshoj banës me qira në lagjen "Dardania" në Prishtinë. Banesa ka 50 m2, me inventar të kompletuar, banesa ka kuzhinë me sallon, teras, banjo një dhomë gjumi, shpajz dhe korridor, banesa lëshohet për një qift ose për dy vajza. Tel: 04471328.

► Lëshoj shtëpinë me qira në lagjen Velania, pa pagesë sepse shtëpia ka nevojë për përkujdesje ndërsa shpenzimet mujore ti bëjë vetë banuesi si: ujë rrym bërlllok, Tel: 044-608-626.

► Lëshoj banës me qira për student apo familjar në lagjen "Mati 1" Rr. "Muharrem Fejza", banesa është 70 m2 dhe i plotëson të gjitha kushtet, kati dytë ndërtim i ri tel: 044-686-900.

► Lëshoj banesë me qira, banesa është ndërtim i ri dhe gjendet në lagjen "Mati 1" rruga "Muharrem Fejza" Prishtinë. Tel: 044-686-900.

► Lëshoj banesë me qira në lagjen "Mati 1" përball "Super Vivës", me sipërfaqe mbi 50 m2, kati dytë me ngrohje, klimë, ashensorë etj, çmimi 200 Euro. Tel: 044-185-233.

► Lëshoj banesë me qira garsoniere në Ulpian kati i parë, posedon tre shtretër dhe e mobiluar. Preferohet për studenta ose studente, një qift apo të tjerë. Çmimi është 185 euro. Tel: 044-812-875.

► Lëshoj garsonjer me qira në lagjen Ulpiana kati i parë. Banesa është e mobiluar dhe i plotëson të gjitha kushtet për banim, preferohet për një qift apo tre studentë, mund të merret për kohë të shkurt apo të gjatë. Çmimi është 180 Euro. Tel: 044-812-875.



ANNOUNCING THE 2017 QUALITY & SALES AWARDS

Quality & Sales Award Recipients

[Listed in alphabetical order]

- ★ ARC Refreshments Corporation- Antipolo **Philippines**, Quality
- ★ Embotelladora Central S.A **Paraguay**, Quality
- ★ Fabrica de Bebidas Gaseosas Salvavidas S.A. **Guatemala**, Quality
- ★ Fluidi Sh.p.k. **Kosovo**, Quality
- ★ Indústria e Comercio de Bebidas Funada Ltda **Brazil**, Quality
- ★ Interbrand S.A.L. **Lebanon**, Sales
- ★ Kofola ČeskoSlovensko a.s. **Czech Republic**, Quality
- ★ Obi Zulol CJSC **Tajikistan**, Quality
- ★ Partex Sales sales Beverages Ltd. **Bangladesh**, Quality
- ★ Soft Drinks Georgia **Georgia**, Sales

